

VENDIM
Nr. 733, datë 3.12.2025

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË AGJENDËS DIGJITALE PËR
ARSIMIN 2025–2030, DUKE PËRFSHIRË STANDARDET PËR ARRITJEN E
KOMPETENCËS DIGJITALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit të Agjendës Digjitale për Arsimin 2025–2030, duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe të gjitha institucionet përgjegjëse të përmendura në tekstin e këtij plani veprimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLANI I VEPRIMIT I AGJENDËS DIGJITALE PËR ARSIMIN 2025–2030
_____, 2025

Përmbajtja

Sfondi dhe konteksti

Metodologjia

Kapitulli 1: Situata aktuale 7

Kapitulli 2: Vizioni, politikat dhe objektivat e politikave

A. Vizioni

B. Politikat dhe objektivat e politikave

1. Zgjerimi i Laboratorëve Inteligjentë (*SmartLabs*) në të gjitha shkollat deri në vitin 2027

2. Blerja e 5,500 laptopëve për mësuesit e gjimnazeve

3. Vazhdimi i zgjerimit të lidhjes me brez të gjerë (*Broadband*) dhe Wi-Fi me shpejtësi të lartë në të gjitha shkollat

4. Krijimi i platformës kombëtare për menaxhimin e informacionit kërkimor shkencor (ACRIS)

5. Krijimi i një mekanizmi të zbatimit të planit të veprimit të agjendës digjitale për arsimin 15

6. Vendosja e standardeve të shkallëzuara për pajisjet digjitale dhe ndërlidhjen për institucionet e arsimit të lartë

7. Treguesit kombëtarë të arsimit dhe roli i tyre si pjesë e kuadrit të administrimit të të dhënave

8. Zhvillimi dhe zbatimi i udhëzimeve dhe rasteve praktike për përdorimin e IA-së gjeneruese (GenAI)

9. Zhvillimi i një plani për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për programe/kurse të teknologjisë së avancuar në Institucionet e arsimit të lartë

10. Përfshirja e Inteligjencës Artificiale në kurrikulën e TIK-ut në arsimin parauniversitar

11. Zgjerimi i trajnimeve në TIK për të gjithë mësuesit dhe ofrimi i mbështetjes për trajnime bazuar në vlerësime periodike
 12. Lidhja e programeve të studimit në fushën e mësuesisë me kompetencat digjitale për mësuesit
 13. Përditësimi i mekanizmit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional *online* (ZHP) për mësuesit
 14. Vazhdimi i përmirësimit të gjithëpërfshirjes në arsimin digjital
 15. Vazhdimi i përditësimit të kurrikulës dhe kompetencave të TIK-ut për arsimin parauniversitar
 16. Zhvillimi dhe zbatimi i një programi edukimi për higjienën digjitale
 17. Përdorimi efektiv i Laboratorëve Inteligjentë (*SmartLabs*)
 18. Përditësimi i përmbajtjes digjitale në përputhje me kurrikulën e përditësuar
 19. Krijimi i një udhërrëfytyrës për të rritur vizibilitetin në internet të institucioneve të arsimit të lartë
 20. Bashkëpunimi me Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës për përdorimin e teknologjisë në arsim
 21. Organizimi i festivalit kombëtar për arsimin digjital
 22. Krijimi i mekanizmave për njohjen e krediteve të programeve/kurseve specifike Kurse Masive të Hapura *Online*” (MOOCs) sipas kërkesës së tregut
- Kapitulli 3: Burimet financiare
PLANI I ZBATIMIT – VLERËSIMI I KOSTOS/NDIKIMI NË BUXHET
MATRICA E REZULTATEVE

Sfondi dhe konteksti

Edukimi digjital nuk është më thjesht një vizion i së ardhmes; ai është bërë një domosdoshmëri. Pandemia e COVID-19 theksoi rëndësinë kritike të të pasurit mjedise të të mësuarit që janë fleksibël, të drejtura nga teknologjia dhe të afta për të përballuar kufizimet dhe sfidat.



... drejta për një lidhje kuptimplotë me internetin dhe mësimdhënie digjitale është gjithnjë e më shumë sinonim i së drejtës për arsim...
Global Monitoring Report – GEM, UNESCO (2023)

Edukimi digjital mund të ndihmojë në krijimin e fleksibilitetit dhe të qëndrueshmërisë së sistemit, të përgatisë fuqinë punëtore të së ardhmes, të përmirësojë metodat e të nxënies përmes teknologjisë dhe të jetë kosto efektive në planin afatgjatë.

Shtetet në të gjithë botën po miratojnë gjithnjë e më shumë strategji dhe politika të edukimit digjital. Që nga viti 2020, afërsisht gjysma e vendeve të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) kishin strategji specifike për arsimin digjital (van der Vlies, 2020). Këto politika në përgjithësi ishin pjesë e strategjive më të gjera kombëtare të inovacionit digjital, që synonin pajisjen e brezit të ardhshëm me aftësitë dhe mjetet digjitale të nevojshme për të qenë të suksesshëm në një shoqëri digjitale me ritme të shpejta. Përhapja e COVID-19 vuri në dukje gjendjen aktuale të digjitalizimit dhe nxiti nisma shtesë për të përmirësuar arsimin digjital.

 Singapori	EdTech Master Plan 2030	 Slovenia	Digital Education Action Plan (ANDI)	 Spanja	Educa en Digital 2024-30
 Finlanda	Policies for the Digitalization of Education & Training 2023-27	 Franca	Digital Strategy for Education 2023 – 2027	 Malta	Digital Education Strategy 2024 - 2030

Qeveria e Shqipërisë ka bërë përparim të rëndësishëm në përmirësimin e përdorimit dhe në ritjen e këtyre aftësive. E drejtuar nga vizioni i saj strategjik, Shqipëria ka përcaktuar prioritetet kryesore për të forcuar ofrimin dhe menaxhimin e arsimit digjital. Këto prioritete pasqyrohen në disa dokumente themelore, duke përfshirë:

- Strategjinë Kombëtare të Arsimit (2021–2026), miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”;

- Strategjinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin (2023–2030), miratuar me vendimin nr. 542, datë 20.9.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”;

- Agjendën Digjitale të Shqipërisë 2022–2026, miratuar me vendimin nr. 370, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale ‘Agjenda Digjitale e Shqipërisë’ dhe të planit të veprimit 2022–2026”.

- Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, miratuar me vendimin nr. 173, datë 24.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023–2024”;

- Strategjinë Kombëtare për Rininë dhe Plani i Veprimit 2022–2029, miratuar me vendimin nr. 692, datë 26.10.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe planit të veprimit 2022–2029”.

- Strategjia Kombëtare e Specializimit Inteligjent (S3) 2025–2030 dhe e planit të veprimit për zbatimin e saj datë 26.12.2024, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 26.12.2024.

Disa nga fushat kryesore të fokusit mbi komponentin digjital në këto dokumente strategjike përfshijnë:

Kategoria	Detajet
Infrastruktura digjitale	- Vendorsja e standardeve për pajisjet TIK - Laboratorët inteligjentë (<i>SmartLabs</i>) - Përmirësimi i shpejtësisë së internetit dhe mbulimit me Wi-Fi
Zhvillimi i kompetencës digjitale të mësuesve	- Përafrimi me kornizën e BE-së - Përfshirja e kompetencës digjitale në standardet e mësuesit - Trajnimi i vazhdueshëm për stafin mësues
Literatura digjitale për nxënësit	- Përfshirja e lëndës së TIK-ut në të gjitha klasat e arsimit parauniversitar dhe përditësimi i kësaj kurrikule - Qendrat e teknologjisë jashtë kurrikulës - Zbatimi i mësimit të kombinuar dhe përdorimi i materialeve digjitale

Për të garantuar një drejtim të qartë dhe të qëndrueshëm në zhvillimin e arsimit digjital, Ministria e Arsimit po prezanton planin e veprimit të Agjendës Digjitale për Arsimin. Ky plan synon përshtatjen graduale dhe zbatimin efektiv të teknologjisë në të gjitha nivelet e sistemit arsimor.

Kjo qasje është në përputhje me qëllimet kombëtare, siç përshkruhet në dokumentet strategjike kryesore, si: Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 dhe Agjenda Digjitale e Shqipërisë (2022–2026), duke e vendosur Shqipërinë në pozicionin e duhur për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare dhe për të integruar më tej praktikatat digjitale në sistemi arsimor.

Metodologjia

Është zbatuar një metodologji dhe qasje e strukturuar për zhvillimin e këtij plani veprimi, e cila përfshin zhvillimin e kornizës, vlerësimin e situatës aktuale dhe analizën krahasuese me vendet e përzgjedhura.

Si pjesë e **procesit të zhvillimit të kornizës** është ndërmarrë një shqyrtim gjithëpërfshirës i literaturës, duke u mbështetur në burimet kryesore, si: rezolutat dhe rekomandimet për arsimin digjital (Komisioni i BE-së, 2021, 2023), Modelimi i Arsimit Digjital: Faktorët Mundësues për Cilësi, Barazi dhe Eficiencë (OECD 2023) dhe Indeksi i Gatishmërisë së Teknologjisë së Edukimit (Banka Botërore, 2023). Bazuar në gjetjet nga literatura dhe konsultimin me ekspertë, u hartua një kornizë e përshtatur dhe dedikuar për kryerjen e analizës. Korniza (shihni figurën 1) përbëhet nga gjashtë dimensionet kyçe: infrastruktura, qeverisja, politikat dhe programet, burimet njerëzore, pedagogjia dhe pjesëmarrja e ekosistemit.




Figura 1. Struktura e personalizuar për analizë

Për analizën e gjendjes aktuale janë angazhuar të gjithë aktorët kryesorë në Ministrinë e Arsimit dhe strukturat e varësisë së saj, si dhe përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Janë kërkuar, gjithashtu, pikëpamjet e palëve të interesuara joqeveritare, duke përfshirë Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), Fondin Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit (AADF), Bankën Botërore, Fondacionin e Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Këshillin e Evropës (KiE). Intervistat u strukturuar përmes pyetësorëve të detajuar dhe të hartuar mbi bazën e kornizës së mësipërme. Këto intervista mundësuan njohuri më të thelluara mbi gjendjen aktuale të arsimit digjital. Për më tepër, janë vlerësuar, gjithashtu, mbi 30 dokumente strategjike kombëtare dhe sektoriale për të shqyrtuar iniciativat në implementim dhe ato të planifikuara mbi arsimin digjital.

Analiza krahasuese konsistoi në identifikimin e praktikave më të mira në arsimin digjital në vendet e përzgjedhura, si: Estonia, Singapori, Spanja, Sllovenia dhe Izraeli. Në kuadër të këtij procesi u vlerësuan dokumentet publike që disponoheshin dhe u angazhuam me ekspertë vendës dhe ndërkombëtarë për të mësuar nga përvojat këtyre vendeve. Gjithashtu, u morën në shqyrtim studime dhe raporte ndërkombëtare, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në perspektiva për arsimimin digjital OECD 2023 (*OECD's Digital Education Outlook*), Plani i Veprimit për Arsimin Digjital të BE-së 2021–2027 (*EU's Digital Education Action Plan*) dhe analiza e

sektorit të arsimit e mbështetur nga UNICEF-i në vitin 2024 (*UNICEF's Education Sector Analysis of Albania*).

Procesi i konsolidimit përfshiu identifikimin e një liste gjithëpërfshirëse politikash, duke nxjerrë përfundime nga standardet ndërkombëtare, strategjitë kombëtare, intervistat e palëve të interesuara dhe sfidat sektoriale. Më pas, u përshtatën këto politika për të siguruar përafrimin me situatën aktuale të arsimit në Shqipëri.

Së fundi, u kategorizuan këto politika në objektiva strategjike kyç, siç janë: përmirësimi i infrastrukturës digjitale, implementimi i teknologjive inovative dhe promovimi i kurrikulave digjitale gjithëpërfshirëse. Kjo qasje e strukturuar ndihmoi në krijimin e një pakete prej 26 rekomandimesh, të priorituara për implementim (afatshkurtër/afatmesëm/afatgjatë), bazuar në faktorë të tillë, si lehtësia e implementimit, kërkesat për burime dhe varësitë ndërmjet tyre.

Kapitulli 1: Situata aktuale

Ky seksion përmban një vlerësim të detajuar të gjendjes aktuale të sistemit arsimor parë kjo nga perspektiva e arsimit digjital.

Qeveria e Shqipërisë ka treguar një angazhim të fortë për integrimin e teknologjive digjitale në të gjithë sektorin e arsimit. Përmes një sërë reformash të koordinuara mirë, vendi ka avancuar në infrastrukturë, korniza politike, mjete digjitale dhe nisma për zhvillimin e mësuesve, me synimin për t'i pajisur si nxënësit, ashtu edhe mësuesit me aftësitë e shekullit XXI.

Përparime të rëndësishme janë bërë në përmirësimin e infrastrukturës digjitale. Të gjitha shkollat në Shqipëri tashmë përfitojnë nga qasja në internet, falë bashkëpunimit midis Ministrisë së Arsimit, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Mbështetja teknike për shkollat sigurohet përmes mësuesve të TIK-ut, zyrave arsimore vendore dhe kanaleve të komunikimit, si: *email*, telefon dhe portali SMIP. Njëkohësisht, nisma, si *SmartLabs* kanë ndihmuar në përmirësimin e raportit pajisje/nxënës, me përmirësime të vazhdueshme dhe mirëmbajtje të koordinuar nga AKSHI dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar. Në arsimin e lartë, investimet në infrastrukturën digjitale mbështeten nga Agjencia Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë (AKFAL) dhe Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (AKKSHI), të cilat ofrojnë grante për projekte dhe laboratorë digjitalë të veçantë.

Përdorimi i sistemeve moderne të informacionit ka transformuar mënyrën se si menaxhohen dhe përdoren të dhënat në arsim. Në nivelin parauniversitar, Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP), krijuar me vendimin nr. 742, datë 3.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar (SMIP), u mundëson shkollave të digjitalizojnë të dhëna, si frekuentimi dhe notat, duke mundësuar raportim dinamik dhe planifikim të bazuar në të dhëna. Një platformë e ngjashme, SMIAL, është zhvilluar nga MA-ja dhe AKSHI për të menaxhuar të dhënat e arsimit të lartë, duke zgjeruar më tej infrastrukturën digjitale të sistemit arsimor. Përveç sistemeve të të dhënave, mjete digjitale, si SMIP-i, ofrojnë ndërveprim në kohë reale midis nxënësve, mësuesve dhe prindërve, ndërsa Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) u siguron institucioneve të arsimit të lartë dhe shkollave akses në sisteme si *U-Albania*, *U-GO* dhe *PITAGORA*, së bashku me një platformë trajnimit *online* për mësuesit.

Nga pikëpamja e qeverisjes, arsimi digjital është i integruar në kuadrin më të gjerë strategjik të Shqipërisë. Iniciativa të qeverisë, si pajisja e shkollave me *SmartLabs*, futja e kodimit që në klasën e parë dhe Programi Kombëtar për Zhvillimin Profesional të Mësuesve pasqyrojnë një vizion të qartë për ndërtimin e kompetencave digjitale, që nga arsimi i fillor deri në arsimin e lartë. Gjithashtu reformat digjitale në arsim në Shqipëri mbështeten nga disa strategji kombëtare – përfshirë Strategjinë Kombëtare të Arsimit (2021–2026), Agjendën Digjitale (2022–2026) dhe Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin (2023–2030).

Në aspektin e zbatimit të politikave, Ministria e Arsimit dhe institucionet në varësi të saj kanë zhvilluar standarde dhe udhëzime të detajuara për të mbështetur zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve dhe nxënësve, veçanërisht në sistemin parauniversitar. Kurrikula e re e TIK-ut për klasat I–III, e zhvilluar nga ASCAP-i, në bashkëpunim me një grup ndërinstytucional dhe ekspertizë të huaj, siguron koherencë në mësimdhënien digjitale, ndërsa Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë udhëzon zhvillimin e infrastrukturës së TIK-ut në institucionet e arsimit të lartë. MA-ja është duke zbatuar në mënyrë aktive një portofol programesh që mbështetin këto politika. Veçanërisht, programi *SmartLabs* po pajis shkollat me mjete digjitale moderne, duke mbështetur zhvillimin e kurrikulës së re të TIK-ut dhe aftësive të kodimit, që nga klasat e para të arsimit bazë. Ky program mbështetet nga Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) dhe Banka Botërore. Ndërkohë, Programi Kombëtar për Zhvillimin Profesional të Mësuesve, i nisur në vitin 2024, ofron trajnime për rreth 16,000 mësues, në fusha si qasja STEM, aftësitë digjitale, standardet ndërkombëtare (PISA, TALIS) dhe praktikatat gjithëpërfshirëse.

Integrimi i sistemeve të informacionit si SMIP dhe SMIAL forcon më tej ofrimin e arsimit digjital. SMIP-i lehtëson planifikimin e mësimëve, ndjekjen e rezultateve dhe përmirëson komunikimin ndërmjet shkollave dhe prindërve, ndërsa SMIAL ndihmon në menaxhimin e numrit të regjistrimeve të studentëve në të gjitha institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë.

Po ashtu sistemi *e-Matura* është tashmë një komponent kyç i digjitalizimit të procesit të Maturës Shtetërore në Shqipëri. Ai mbulon të gjithë ciklin e administrimit të provimeve, duke përfshirë: aplikimin e kandidatëve përmes portalit *e-Albania*; konfirmimin e aplikimeve nga shkollat; ndarjen në qendra provimi; krijimin e listave dhe raporteve të materialeve; menaxhimin e sekretimit dhe pikëve të provimeve; përlllogaritjen e notave; gjenerimin e diplomës; si dhe dërgimin e të dhënave përkatëse në sistemet shtetërore, si SMIP. Gjithashtu, ofron shërbimet *online* për aplikimin dhe administrimin e kërkesave për kopje testi.

Gjithëpërfshirja është, gjithashtu, një përparësi kyçe në sistemin arsimor. Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 parashikon përdorimin e mjeteve digjitale për të mbështetur fëmijët me aftësi të kufizuara, përfshirë teknologjitë ndihmëse për sfida vizuale, dëgjimore dhe të të nxënësve. Këto përpjekje plotësohen nga partneritete ndërinstytucionale, që sjellin ekspertizë teknike dhe financim, si dhe nga organizata dhe donatorë ndërkombëtarë.

Financiarisht, qeveria ka ndarë burime të konsiderueshme për të avancuar arsimin digjital. Monitorimi i këtyre investimeve dhe nismave përkatëse kryhet nga Drejtoria e Statistikave, Jetësimit të Prioriteve dhe Projekteve, e cila, gjithashtu, mbikëqyr raportimin mbi strategjinë kombëtare në përgjithësi përmes vlerësimeve periodike të rregullta.

Ndërtimi i kapitalit njerëzor mbetet një shtyllë qendrore e transformimit të arsimit digjital në Shqipëri. MA-ja dhe institucionet e saj të varësisë luajnë role kyçe në rekrutimin, certifikimin, trajnimin dhe vlerësimin e performancës së mësuesve. Institucionet, si Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe ASCAP-i kanë zhvilluar standarde gjithëpërfshirëse për integrimin e TIK-ut në procesin mësimor, mbështetur nga trajnime përkatëse, ndërsa AKSHI dhe ZVAP-të ofrojnë mbështetje teknike. Programi Kombëtar për Zhvillimin e Mësuesve 2024 përfshin module të fokusuar në kodim, aftësi digjitale dhe metodologji të mësimdhënies dhe aktualisht mbështet rreth 1,340 mësues të TIK-ut dhe të arsimit fillor me programe trajnimi të përshtatura për përmirësimin e aftësive digjitale të nxënësve në shkollat e pajisura me *SmartLabs*.

Ndërkohë kurrikula e re e lëndës së TIK-ut është duke u implementuar për klasat I–III dhe njëkohësisht është duke u punuar për rishikimin dhe përditësimin e të gjitha programeve mësimore të TIK-ut deri në klasën XII. Në zbatim të kurrikulës së re të TIK-ut për klasat I–III, platforma SMIP, gjithashtu, u mundëson mësuesve dhe nxënësve aksesimin direkt të platformës së kodimit *CodeMonkey*. Gjatë pandemisë COVID-19 u zhvilluan platforma dhe kanale, si

Akademi.al dhe RTSH Shkolla, për të ofruar mësim të bazuar në video, të cilat vazhdojnë të jenë aktive, duke shërbyer si arkiva të pasura të mësimi digjital, të aksesueshme nga të gjithë.

Së fundmi, pjesëmarrja më e gjerë inkurajohet përmes angazhimit në kohë reale të prindërve të mundësuar nga SMIP-i, si dhe përmes partneriteteve efektive publike-private dhe me donatorë. Bashkëpunimet me Vodafone, Akademi.al, AADF dhe UNICEF kanë luajtur një rol kyç në mbështetjen e reformave digjitale të qeverisë, veçanërisht në arsimin parauniversitar.

Në mënyrë të përmbledhur, Shqipëria ka ndërtuar një bazë të fortë për arsimin digjital në të gjithë sistemin e saj arsimor. Përmes infrastrukturës së integruar, planifikimit strategjik, bashkëpunimit ndërsektorial dhe programeve të dedikuara për trajnimin e mësuesve, qeveria vazhdon ta pozicionojë arsimin digjital si një përparësi kombëtare për një mësim gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt së ardhmes.

Kapitulli 2: Vizioni, politikat dhe objektivat e politikave

A. Vizioni

Në krijimin e vizionit për planin e veprimit të agjendës digjitale për arsimin në Shqipëri, u analizuan prioritetet kombëtare, u vlerësua gjendja aktuale e sistemit arsimor dhe u krahasuan me praktikën më të mira globale. Ky proces përfshiu një rishikim të strategjive kryesore kombëtare, të tilla si: Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 dhe Agjenda Digjitale e Shqipërisë dhe u angazhuan palët e interesuara për të identifikuar aspiratat arsimore të Shqipërisë. Për më tepër, njohuritë ndërkombëtare të përftuara nga analiza e vendeve, si: Finlanda, Singapori dhe Estonia, ndihmuan në evidentimin e temave thelbësore që duhet të orientojnë qasjen e Shqipërisë – më specifikuat inovacioni, gjithëpërfshirja, iniciativat me vizion të qartë, angazhimi global, fokusi në cilësi dhe integrimi digjital.

Bazuar në këto tema, më poshtë evidentohet deklarata e vizionit:

Duke synuar ndërtimin e një shoqërie të fuqizuar në mënyrë digjitale, Shqipëria angazhohet të transformojë sistemin e saj arsimor deri në vitin 2030, përmes modernizimit të infrastrukturës, përdorimit të teknologjive inovative, zhvillimit të kurrikulave digjitale gjithëpërfshirëse dhe fuqizimit të kapaciteteve profesionale të mësuesve.

Nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm dhe të strukturuar të mësuesve, në përputhje me Kornizën Evropiane të Aftësive Digjitale për Edukatorët (DigCompEdu), çdo mësues do të pajiset me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të integruar me sukses teknologjinë në mësimdhënie dhe për të udhëhequr procesin e të nxënës në mjedise të ndryshme, fizike dhe digjitale.

Ky vizion synon të sigurojë që çdo nxënës dhe student në Shqipëri të ketë akses të barabartë në mundësi cilësore për të nxënë, të zhvillojë kompetencat digjitale dhe të jetë i përgatitur për sfidat dhe mundësitë e një bote digjitale në ndryshim të vazhdueshëm.

B. Politikat dhe objektivat e politikave

Nr.	Objektivat dhe politikat
Objektivi 1: Zgjerimi dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore digjitale	
1	Zgjerim i <i>SmartLabs</i> në të gjitha shkollat deri në vitin 2027
2	Blerja e 5,500 laptopëve për mësuesit e gjimnazeve
3	Vazhdimi me zgjerimin e lidhjes me internet <i>Broadband</i> dhe Wi-Fi me shpejtësi të lartë në të gjitha shkollat
4	Krijimi i platformës kombëtare për menaxhimin e informacionit kërkimor shkencor (ACRIS)
Objektivi 2: Zhvillimi i standardeve të qeverisjes dhe i monitorimit të arsimit digjital	
5	Krijimi i një mekanizmi për zbatimin dhe mbështetjen e Planit të Veprimit të Agjendës për Arsimin
6	Vendosja e standardeve të niveleve të ndryshme për pajisjet digjitale dhe ndërlikohen në institucionet e arsimit të lartë
7	Finalizimi i treguesve kombëtarë të arsimit dhe miratimi i një strukture të fortë të administrimit të të dhënave arsimore
Objektivi 3: Mundësimi dhe inkurajimi në implementimin e teknologjive inovative, si IA	
8	Zhvillimi dhe zbatimi i udhëzimeve dhe rasteve praktike për përdorimin e IA Gjeneruese (<i>Generative</i>

	AI)
9	Zhvillimi i një plani për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për kurset e teknologjisë së avancuar në institucionet e arsimit të lartë
10	Përfshirja e edukimit mbi IA në kurrikulën e TIK-ut
Objektivi 4: Rritja dhe mbështetja e aftësive digjitale të mësuesve	
11	Zgjerimi i trajnimeve për TIK-un për të gjithë mësuesit dhe ofrimi i mbështetjes për trajnime bazuar në vlerësime periodike
12	Lidhja e programeve të studimit në fushën e mësuesisë me kompetencat digjitale të kërkuara për mësuesit
13	Përditësimi i mekanizmit <i>online</i> të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për mësuesit
14	Vazhdim i përmirësimit të gjithëpërfshirjes në arsimin digjital
Objektivi 5: Promovimi i kurrikulave digjitale të përditësuara dhe gjithëpërfshirëse	
15	Vazhdimi i përditësimit të kurrikulës dhe kompetencave të TIK-ut për arsimin parauniversitar
16	Zhvillimi dhe zbatimi i një programi edukimi për higjienën digjitale
17	Përdorimi efektiv të Laboratorëve Inteligjent (<i>SmartLabs</i>)
18	Përditësimi i përmbajtjes digjitale në përputhje me kurrikulën e përditësuar
Objektivi 6: Inkurajimi i angazhimit shumëpalësh në edukimin digjital	
19	Krijimi i një udhërrëfyese për të rritur shikueshmërinë në internet të institucioneve të arsimit të lartë dhe shkollave
20	Bashkëpunimi me Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës për përdorimin e teknologjisë në arsim
21	Organizimi i festivalit të mësimin digjital në Shqipëri
22	Krijimi i mekanizmave për njohjen e krediteve të programeve/kurseve specifike Kurse Masive të Hapura <i>Online</i> (MOOCs), sipas kërkesës së tregut

Objektivi 1: Zgjerimi dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore digjitale

1. Zgjerimi i Laboratorëve Inteligjent (*SmartLabs*) në të gjitha shkollat deri në vitin 2027

Kjo masë politike përputhet me përpjekjet e vazhdueshme për zgjerimin e laboratorëve inteligjentë në të gjithë territorin e Shqipërisë. Qeveria Shqiptare, në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), prezantoi Laboratorët Inteligjentë (*SmartLabs*) në 100 shkolla, në kuadër të projektit *ElementIT*. Këta laboratorë ofrojnë akses për nxënësit në teknologjinë më të avancuar digjitale, duke përfshirë laptopë, tabela inteligjente, projektorë, kite robotike etj.

Gjatë vitit 2024–2025, në bashkëpunim me Bankën Botërore, u realizua instalimi i 216 laboratorëve inteligjentë në 200 shkolla, ndërkohë që planifikohet pajisja e edhe 654 laboratorëve të tjerë në 616 shkolla, me mbështetjen e Bashkimit Evropian (Bankës së Zhvillimit të Këshillit të Evropës). Këta laboratorë do të shërbejnë si bazë për zbatimin e kurrikulës së re të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për klasat I, II dhe III, me synimin për ta shtrirë në të gjithë sistemin parauniversitar.

2. Blerja e 5,500 laptopëve për mësuesit e gjimnazeve

Blerja e 5,500 kompjuterëve portativë (laptopë), si pjesë e mbështetjes së qeverisë shqiptare për digjitalizimin e arsimit dhe rritjen e aksesit në teknologji për nxënësit dhe mësuesit në shkollat publike. Kjo ndërhyrje është pjesë e Programit Operacional Shumëvjeçar “Ekonomia dhe Shoqëria Digjitale 2024–2027”, e financuar nga IPA III, dhe synon përmirësimin e kushteve të të nxënës, fuqizimin e përdorimit të platformave digjitale arsimore dhe mbylljen e hendekut digjital midis zonave urbane dhe rurale.

Rezultati i planifikuar:

- Krijimi i laboratorëve *SmartLabs* me akses për çdo shkollë;
- Blerja e 5,500 laptopëve për mësuesit e gjimnazeve.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- Përmirësimi i raportit nxënës-për-pajisje;
- Qasje universale në pajisjet TIK.

3. Vazhdimi i zgjerimit të lidhjes me brez të gjerë (*Broadband*) dhe Wi-Fi me shpejtësi të lartë në të gjitha shkollat

Kjo masë synon të vazhdojë zgjerimin e lidhjes me brez të gjerë në shkolla për të mundësuar adaptimin dhe integrimin pa probleme të arsimit dhe mësimin digjital.

Ka iniciativa të vazhdueshme si pjesë e “Planit Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale, *Broadband* (2020–2025)” që synojnë të zgjerojnë brezin e gjerë me shpejtësi të lartë (të paktën 30 Mbits) për të gjitha shkollat deri në vitin 2025. Si pjesë e Programit të Rritjes dhe Reformës së BE-së, Qeveria e Shqipërisë është angazhuar të lidhë 95% të shkollave publike me një lidhje interneti me shpejtësi të lartë’ deri në vitin 2025.

Rezultati i planifikuar:

- Krijimi i Laboratorëve *Smart* me akses për çdo shkollë dhe, në mënyrë të tërthortë, akses në internet me shpejtësi të lartë.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- Akses në internet me shpejtësi të lartë për të gjitha institucionet arsimore dhe integrim i pandërprerë i mësimin digjital.

Kutia 1. Sistemet e Informacionit mbi Studentët

Mbi 65% e vendeve të OBEZH-së (OECD) përdorin sisteme informacioni mbi studentët, të cilat ofrojnë akses në kohë reale në të dhënat e tyre dhe mjete analitike për palët e interesuara. Këto sisteme shërbejnë për qëllime të ndryshme, të tilla si mbështetje për kërkime dhe raporte, duke mbledhur të dhëna të detajuara për hartimin e politikave. Gjithashtu, ndihmojnë në përmirësimin e e-qeverisjes (elektronike) nëpërmjet proceseve të standardizuara, si: regjistrimi dhe shpërndarja e burimeve, si dhe përmirësimin e mësimin të personalizuar përmes *feedback*-ut të dedikuar për mësuesit dhe nxënësit. Për shembull, **Kanadaja** përdor sistemin OnSIS për regjistrimin dhe mbledhjen e të dhënave socio-ekonomike për të ndihmuar vendimmarrjen në nivel rajonal, ndërsa **Letonia** dhe **Koreja** përdorin sisteme të ngjashme për ndjekjen e performancës dhe pjesëmarrjes. **Estonia** e ka integruar sistemin e saj me shërbimet e e-qeverisjes për të mbështetur mësimin gjatë gjithë jetës, ndërsa **Zelanda e Re** dhe **Uellsi i Ri Jugor** përdorin sistemet e tyre për të mbledhur të dhëna të detajuara mbi vlerësimin, duke mundësuar *feedback* të personalizuar mësuesor dhe matje të angazhimit.

4. Krijimi i platformës kombëtare për menaxhimin e informacionit kërkimor shkencor (ACRIS)

Planifikohet ngritja e një platforme kombëtare të centralizuar – **ACRIS (Albanian Current Research Information System)** – për menaxhimin gjithëpërfshirës dhe të standardizuar të informacionit kërkimor shkencor në Shqipëri. Sistemi do të shërbejë si bazë e vetme reference për grumbullimin, administrimin dhe analizimin e të dhënave në lidhje me:

1. Institucionet kërkimore;
2. Kërkuesit shkencorë;
3. Projektet e zbatuara;
4. Publikimet shkencore;
5. Patentat;
6. Infrastrukturën kërkimore;
7. Burimet e financimit; dhe
8. Rezultatet e arritura nga kërkimi shkencor.

Platforma ACRIS do të mundësojë integrim me sisteme të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe do të rrisë transparencën, llogaridhënien dhe përdorimin e të dhënave për qëllime analitike dhe vendimmarrëse në fushën e kërkimit dhe inovacionit.

Objektivi 2: Zhvillimi i standardeve të qeverisjes dhe monitorimit të arsimit digjital

5. Krijimi i një mekanizmi të zbatimit të planit të veprimit të agjendës digjitale për arsimin

Ministria e Arsimit fokusohet në edukimin digjital me iniciativa kyçe, si përfshirja e lëndës së TIK-ut që nga klasa e parë, rishikimi i kurrikulave TIK për të gjitha klasat, instalimi i laboratorëve inteligjentë (*SmartLabs*) për shkollat dhe programi i trajnimit të Inteligjencës Artificiale për të rinjtë. Këto nisma janë në bashkëpunim me institucione e tjera (p.sh. AKSHI) dhe palët e interesuara joqeveritare (p.sh. AADF, UNICEF etj.). Megjithatë ekzistojnë grupe pune dhe mekanizma të tjerë në nivele projektsh/iniciativash, nuk ka një mekanizëm të vetëm për drejtimin, monitorimin dhe mbështetjen e zbatimit të nismave të arsimit digjital.

Kjo masë politike synon të krijojë një mekanizëm të dedikuar për monitorimin e zbatimit efektiv dhe në kohë të planit të veprimit të agjendës digjitale për arsimin. Ky mekanizëm do të drejtojë koordinimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve të arsimit digjital nëpër institucione.

Zbatimi i këtij plani veprimi do të monitorohet nga grupi i punës i ngritur nga ministria përgjegjëse për arsimin. Ky proces do të realizohet përmes takimeve të rishikimit periodik, duke përfshirë vlerësime gjatë periudhës së implementimit. Gjithashtu, do të vijojë mbështetja e Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, si institucione që luajnë rol të rëndësishëm në integrimin e teknologjisë, bazuar në mirëkuptimin dhe diskutimet e përbashkëta mes palëve.

Rezultat i planifikuar:

- Miratimi i një mekanizmi monitorues që përfshin monitorimin dhe raportimin periodik të zbatimit të planit të veprimit.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- Monitorimi dhe zbatimi në kohë: Siguron që plani i veprimit të agjendës digjitale për arsimin të zbatohet brenda afateve kohore të përcaktuara, duke ruajtur llogaridhënien.

- Koordinim i centralizuar dhe efikas: Lehtëson mbikëqyrjen qendrore të iniciativave të ndryshme të arsimit digjital, duke ndihmuar në përputhjen e politikave me qëllimet strategjike.

Kutia 2. Qeverisja e arsimit digjital

Shtetet miratojnë modele të ndryshme qeverisjeje për arsimin digjital bazuar në strukturat e tyre federale. Në **Itali**, një Menaxher i Tranzicionit Digjital drejton iniciativat e riorganizimit dhe digjitalizimit për institucionet arsimore. **Singapori** ka dy modele: Aftësitë e së Ardhmes *SkillsFuture*, e drejtuar nga një drejtor i përgjithshëm, që fokusohet në mësimin dhe aftësitë për shekullin XXI gjatë gjithë jetës së individit, si dhe një divizion të specializuar brenda Ministrisë së Arsimit që përqendrohet në iniciativat e edukimit digjital. **Franca** ka një departament të dedikuar nën Ministrinë e Arsimit me nëndrejtori për shërbimet digjitale, infrastrukturën dhe transformimin.

6. Vendosja e standardeve të shkallëzuara për pajisjet digjitale dhe ndërlidhjen për institucionet e arsimit të lartë

Për arsimin parauniversitar, Ministria e Arsimit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) ka zhvilluar dhe zbatuar struktura dhe mekanizma për të siguruar disponueshmërinë e pajisjeve digjitale dhe lidhje të fuqishme të internetit me brez të gjerë.

Në lidhje me arsimin e lartë, Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë është një dokument kyç që ofron një listë të kërkesave për Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), të cilat duhet të akreditohen për të ushtruar veprimtarinë e tyre akademike, sipas kuadrit ligjor në Shqipëri.

Për të rritur më tej efektivitetin e këtyre standardeve, kjo masë rekomandon prezantimin e standardeve të shkallëzuara sipas nivelit. Kjo do të përfshijë standardet minimale që do të jenë të zbatueshme për të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), për të siguruar që të ketë akses universal në infrastrukturën bazë digjitale. Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), që ofrojnë kurse (të avancuara) të TIK-ut do t'iu kërkohej të përmbushin standarde të avancuara

për të siguruar që kurse të tilla të mbështeten nga infrastruktura digjitale e duhur dhe e përditësuar. Kjo qasje siguron që, të gjithë studentët, të kenë akses të barabartë në mjete dhe infrastrukturë digjitale të cilësisë së lartë, të përshtatura për fushat e tyre të studimit, aftësitë dhe synimet për t'i përmirësuar aftësitë në fushën e këtij plani veprimi.

Standardet do të vendosen pas një konsultimi të gjerë me të gjithë aktorët përkatës, duke përfshirë institucionet e arsimit të lartë.

Rezultatet e tjera të mundshme

- Infrastruktura e unifikuar digjitale: Qëndrueshmëri në burimet digjitale në të gjitha IAL-të, duke siguruar që studentët në institucione të ndryshme të kenë akses të barabartë në teknologjinë thelbësore. Rritje e përgatitjes ndaj tregut të punës: Studentët mund të përdorin mjetet përkatëse të TIK-ut, që përputhen me standardet e industrisë, duke i përgatitur më mirë për punësim në të ardhmen.

- Mbështetje për platformat e reja: Infrastruktura e duhur do të rrisë më tepër përqafimin e platformave të reja, siç është Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Arsimin e Lartë (SMIAL), duke përmirësuar proceset administrative dhe mësimore.

7. Treguesit kombëtarë të arsimit dhe roli i tyre si pjesë e kuadrit të administrimit të të dhënave

Ministria e Arsimit është e fokusuar në përmirësimin e matjes së rezultateve arsimore. Tregues digjital të tillë si numri i pajisjeve digjitale, shpejtësia e lidhjes dhe performanca e pajisjeve mbledhen sipas nevojës. Por, me futjen e sistemit SMIP në nivel shkolle, mbledhja dhe raportimi i të dhënave është bërë dinamike dhe efikase.

Strategjia Kombëtare e Arsimit, gjithashtu, parashikon nevojën e zhvillimit të treguesve kombëtarë dhe MA po punon ngushtë me INSTAT-in për të arritur këtë rezultat, në përputhje me kornizat ndërkombëtare të OECD-së, Kombeve të Bashkuara dhe BE etj. Kjo masë rekomandon finalizimin e këtyre treguesve kombëtarë të arsimit dhe miratimin e një kornize për qeverisjen e të dhënave.

Ndërsa digjitalizimi bëhet i pandarë në arsim, një kornizë e strukturuar e qeverisjes së të dhënave është thelbësore për mbledhjen, ruajtjen dhe raportimin e saktë të tyre.

Kjo masë politike përfshin tre hapa kryesorë:

1. Finalizimi i treguesve të arsimit: Përafrimi i treguesve kombëtarë të arsimit në kuadër të këtij plani veprimi me Strategjinë Kombëtare të Arsimit, duke përdorur kornizat ekzistuese si Treguesit e Sistemeve Arsimore të OECD-së, Agjenda 2030 e OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Bashkëpunimit Evropian në Arsim dhe Trajnim. Ky hap siguron që të gjithë treguesit të jenë të standardizuar dhe në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

2. Miratimi i kuadrit të qeverisjes së të dhënave: Zhvillimi i një kornize menaxhimi të të dhënave që përcakton çdo tregues, qartëson përgjegjësitë për mbledhjen e të dhënave, si dhe përcakton metodat e mbledhjes së tyre dhe saktëson udhëzimet mbi frekuencën (shpeshtësinë kohore). Kjo kornizë do të përfshijë hartëzimin e praktikave aktuale dhe përshtatjen e tyre bazuar në praktikën më të mira dhe treguesit e dakordësuar.

3. Sigurimi i përditësimit të paneleve informative: Krijimi ose përditësimi i paneleve informative (*dashboard*) (p.sh., përmes SMIP) për shfaqjen e të gjithë treguesve për palët vendimmarrëse në nivele të ndryshme, nga mësuesit dhe drejtorët deri tek zyrtarët e ministrisë. Paneli do të ofrojë të dhëna të sakta në kohë reale për të mbështetur vendimmarrjen dhe zhvillimin e politikave.

Rezultati i planifikuar:

- Miratimi dhe monitorimi i rregullt i treguesve kombëtarë të arsimit;
- Miratimi i kuadrit të qeverisjes së të dhënave arsimore.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- Përmirësimi i vendimmarrjes bazuar në të dhëna dhe evidenca: Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave mundëson vendimmarrje dhe politika të përshtatura për nevojat aktuale arsimore;

- Zgjerimi i kuptimit të ndikimit të masave politike: Të dhënat e besueshme ndihmojnë në vlerësimin efektiv të ndikimit që kanë ndërhyrjet dhe politikat e implementuara dhe orientojnë përmirësimet e tyre në të ardhmen;

- Raportimi efikas për anketat ndërkombëtare: Indikatorët e standardizuar e bëjnë më të lehtë raportimin e të dhënave tek organizatat ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen në vlerësimet globale.

Objektivi 3: Mundësimi dhe inkurajimi në implementimin e teknologjive inovative

8. Zhvillimi dhe zbatimi i udhëzimeve dhe i rasteve praktike për përdorimin e IA-së gjeneruese (GenAI).

Me publikimin e ChatGPT nga OpenAI në 2022¹, përdorimi i Inteligjencës Artificiale (IA) Gjeneruese ka njohur rritje në mënyrë të ndjeshme. Duke qenë i orientuar për përdorim të përgjithshëm dhe falas, adoptimi i tij në arsim gjithashtu është rritur. Mjetet e IA-së kanë potencial të konsiderueshëm për të pasuruar praktikën arsimore, por ato kërkojnë udhëzime të qarta dhe mbështetje në trajnime për t'u përdorur në mënyrë etike dhe efektive. Ministria e Arsimit është e angazhuar për të avancuar përdorimin e përgjegjshëm të IA në sistemin arsimor.

Kur mjetet e IA përdoren në mënyrë të sigurt dhe etike, mund të mbështesin mësuesit në përpyekjet e tyre mësimore. Kjo masë synon zhvillimin e udhëzimeve shteruese dhe rasteve të përdorimit për të ndihmuar mësuesit që t'i përdorin këto mjete në mënyrë efektive, krijuese dhe me përgjegjësi. Elementet kryesore të udhëzimeve përfshijnë adresimin e kufizimeve dhe pasaktësive algoritmike, ofrimin e rasteve specifike të përdorimit dhe praktikave më të mira, mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe sqarimin e shqetësimeve lidhur me pronësinë intelektuale.

Rezultatet e planifikuara:

- Publikimi i udhëzimeve të IA gjeneruese dhe rasteve përkatëse të përdorimit;
- Implementim i udhëzimeve në të gjitha institucionet arsimore.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe aftësisë për IA-në: mësuesit do të kenë një kuptim më të thellë të mundësive, kapaciteteve, kufizimeve dhe konsideratave etike të IA-së, duke nxitur një përdorim më të informuar dhe të përgjegjshëm;

- Rritja e përdorimit të IA në arsim: udhëzime të qarta dhe shembuj praktikë do të inkurajojnë mësuesit/pedagogët të eksplorojnë aplikimet e IA-së në ambientet e tyre, duke e pasuruar përvojën arsimore;

- Udhëzuesit do të garantojnë përdorimin korrekt të platformave dhe integrimin e tyre me *tool*-e të inteligjencës artificiale për të siguruar rrjedhshmëri dhe përdorim efikas të informacionit në të gjithë zinxhirin arsimor.

9. Zhvillimi i një plani për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për programe/kurse të teknologjisë së avancuar në Institucionet e Arsimit të Lartë

Ka një kërkesë në rritje për sigurinë kibernetike dhe aftësitë e IA në nivel global² dhe në Shqipëri³. Duke pasur parasysh kërkesën globale dhe ndikimet e mundshme të sigurisë të teknologjive të tilla, është e rëndësishme të zhvillohet ekspertiza lokale në këto fusha.

Ministria e Arsimit është e angazhuar të zhvillojë bashkëpunime ndërkombëtare, si një nga masat për të adresuar këtë boshllëk. Kjo bazohet më tej në objektivin e përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Arsimit për ndërkombëtarizimin e IAL-së (objektivi C6.1), duke inkurajuar bashkëpunime që rrisin cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri.

Kjo masë politike thekson bashkëpunimin ndërkombëtar për të krijuar mundësi për studentët e IAL-së, që të studiojnë teknologji të avancuara, të tilla si IA dhe siguria kibernetike. Nga ndërtimi i bashkëpunimeve me institucionet ndërkombëtare, IAL-të shqiptare mund t'u ofrojnë

¹ Prezantimi i ChatGPT | OpenAI

²<https://www.weforum.org/stories/2024/07/why-closing-the-cyber-skills-gap-requires-a-collaborative-approach/>

³ PwC: Emigrimi i të rinjve po kërcënon sigurinë kibernetike të Shqipërisë - Telegrafi - Telegrafi

studentëve një zgjerim të aksesit në njohuritë më të fundit dhe të kontribuojnë në një forcë punëtore të përgatitur për të ardhmen.

Disa nga iniciativat e propozuara përfshijnë:

- *Për studentët:* Krijimi i programeve të shkëmbimit për programe studimi/kurse të fokusuara në IA, si ato të ofruara nga Erasmus dhe projekti LAIA⁴, së bashku me bursa të dedikuara. Bashkëpunimet me platformat MOOC (Kurse Masive të Hapura *Online*) për kurse me kredite në IA mund të zgjerojnë më tej mundësitë e studimit për studentët shqiptar.

- *Për trajnerët:* Organizim program vizitash për profesorë dhe ekspertë të IA-së nga universitetet evropiane (p.sh., përmes projektit READ të AADF-së) dhe mundësimi i leksioneve afatshkurtra nga ekspertë të ftuar mbi tema të specializuara.

- *Për institucionet :* Zhvillimi i projekteve kërkimore të përbashkëta në fushën e IA-së dhe kurse të përbashkëta në IA, (p.sh. Master i Shkencave në IA), duke ndërtuar, gjithashtu, kapacitete akademike lokale përmes programeve të shkëmbimit.

Rezultat i planifikuar:

- Krijimi i një kuadri bashkëpunimi ndërkombëtar për programe/kurse të teknologjisë së avancuar dhe vënia në funksion e 2–3 programeve/kurseve të përbashkëta.

Rezultatet e tjera të mundshme

- Ndërtimi i kapaciteteve të fuqisë punëtore: zgjerimi i grupeve të ekspertëve vendës të trajnuar në IA dhe në sigurinë kibernetike.

- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë: forcimi i lidhjeve midis IAL-së shqiptare dhe evropiane, duke hapur rrugën për bashkëpunime të vazhdueshme.

- Akses në njohuri të avancuara: u ofron studentëve dhe stafit akademik akses më të madh në kërkime, teknologji dhe ekspertiza bashkëkohore, duke nxitur inovacionin dhe kërkimet në fushat kryesore të teknologjisë.

10. Përfshirja e Inteligjencës Artificiale në kurrikulën e TIK-ut në arsimin parauniversitar

Me rritjen e përdorimit të IA-së në jetën tonë të përditshme, edukimi rreth IA po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Konsensusi global i shprehur në dokumentin e UNESCO-s⁵, “Konsensusi i Pekinit për IA-në dhe Arsimin” mbështet integrimin e IA në kurrikulat shkollore.

Kjo masë synon të zhvillojë dhe integrojë Inteligjencën Artificiale (IA) në arsimin parauniversitar, duke e përfshirë brenda edhe në kurrikulën ekzistuese të TIK-ut, veçanërisht për nxënësit nga klasa IV deri në klasat më të larta.

Zbatimi i këtij rekomandimi përfshin tri faza:

- *Zhvillimi:* Përfshirja në mënyrë aktive e mësuesve dhe e ekspertëve të IA-së në procesin e hartimit të kurrikulës, për të siguruar që përmbajtja të përputhet me nevojat arsimore dhe të adresojë sfidat praktike.

- *Integrimi:* Trajnimi i mësuesve për të ofruar konceptet e IA-së në mënyrë efektive. Duhet marrë parasysh që temat dhe konceptet e inteligjencës artificiale mund të përfshihet jo vetëm në programet e trajnimit por edhe në edukimin fillestar të mësuesve.

- *Zbatimi:* Pilotimi i kurrikulës në shkollat me arritje të larta në të nxënë dhe ato me infrastrukturë të përshtatshme, si shkollat me *SmartLabs*, përpara se të shtrihet edhe në shkolla të tjera.

Rezultati i planifikuar:

- Edukimi i IA-së integrohet në kuadrin kombëtar të kurrikulës për arsimin parauniversitar.

Rezultatet e tjera të mundshme:

⁴ LAIA_Project-Announcement_në_Anglisht.pdf

⁵ Konsensusi i Pekinit për Inteligjencën Artificiale dhe Edukimin - Biblioteka Digjitale e UNESCO-s

- *Përmirësim i njohurive në IA*: nxënësit përvetësojnë njohuri bazë dhe të aplikueshme mbi IA-në, duke u përgatitur më mirë për arsimin e mëtejshëm dhe tregun e punës, specifiku në fushën e teknologjisë.

- *Ekspertiza e mësuesve në edukimin e IA*: mësuesit zhvillojnë aftësi të specializuara për mësimdhënien e IA-së, në mënyrë që të udhëheqin nxënësit në mënyrë efektive për përdorimin e IA.

- *Modeli për zgjerim në shkolla të tjera*: përvoja e shkollave pilote krijon një model të suksesshëm dhe shërben si një bazë për zgjerimin e edukimit mbi IA-në edhe në shkolla të tjera në sistemin e arsimit parauniversitar.

Kutia 3. IA në arsim

Ndërsa IA bëhet gjithnjë e më e rëndësishme në arsim, disa vende kanë filluar ta integrojnë atë në kurrikulat e tyre të TIK-ut ose në lëndë të ndryshme. Qasjet e integritit janë të ndryshme, duke përfshirë kurrikula të veçanta për IA-në si lëndë të pavarura, kurrikulat ndërdisiplinore që kombinojnë IA-në me mësimin e bazuar në projekte, kurrikula fleksibël, që shkollat i përshtatin në nivel lokal dhe kurrikula të integruara, që përfshijnë IA në lëndët ekzistuese, si TIK dhe matematika. Për shembull, Kina mbulon IA nga klasat I deri në XII brenda shkencës së informacionit, ndërsa edukimi mbi IA-në në Indi është i përfshirë në laboratorët STEM për klasat VI–XII. Republika e Koresë përfshin IA-në në matematikë dhe në ekonomi shtëpiake për klasat IX–XII, ndërsa Gjermania lejon që rajonet të vendosin për integrimin e kurrikulës së IA-së në klasat I–XII. Këto modele të ndryshme nxjerrin në pah tendencën globale të përfshirjes së IA-së në sistemet arsimore për të përgatitur nxënësit për të ardhmen.

Objektivi 4: Rritja dhe mbështetja e aftësive digjitale të mësuesve

11. Zgjerimi i trajnimeve në TIK për të gjithë mësuesit dhe ofrimi i mbështetjes për trajnime bazuar në vlerësime periodike

I nisur nga Ministria e Arsimit në vitin 2023, Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional të Mësuesve synon zhvillimin holistik të mësuesve. Një aspekt kyç i programit përfshin ofrimin e trajnimit për rreth 1340 mësues të arsimit fillor dhe TIK për përmirësimin e aftësive digjitale të nxënësve në shkollat e pajisura me SmartLab. Gjithashtu, për më tepër, si pjesë e trajnimit të detyruar për të paktën 3 ditë në vit, mësuesit mund të zgjedhin trajnime të ndryshme në fushën e TIK-ut bazuar në nevojat e tyre për zhvillim të vazhdueshëm profesional.

Duke marrë parasysh rritjen e vazhdueshme të përdorimit të teknologjive digjitale në jetën e përditshme dhe në procesin mësimor, është e domosdoshme që të gjithë mësuesit të zotërojnë një nivel minimal të aftësive bazë digjitale. Kjo masë rekomandon trajnimin e detyrueshëm për të gjithë mësuesit në fushën e aftësive bazë në TIK, si dhe në përdorimin efektiv të teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Gjithashtu, ajo parashikon rishikime periodike të kompetencave digjitale të mësuesve, me qëllim ofrimin e mbështetjes dhe mundësive të personalizimit të trajnimit bazuar në nivelin e aftësive digjitale të tyre. Ky trajnim do të realizohet në përputhje me “Standardet Profesionale për Mësuesit mbi përdorimin e TIK-ut” (ASCAP dhe UNESCO, 2020).

Veprimet e propozuara përfshijnë:

- *Trajnim i detyrueshëm për aftësitë bazë të TIK-ut*: zhvillimi dhe kërkesa për një program trajnimi të aftësive bazë digjitale, në përputhje me standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut, hartuar nga ASCAP-i.

- *Përdorim i mjetit SELFIE të BE-së*: ofrimi i aksesit për mësuesit në përdorimin e SELFIE-s, një mjet vetëreflektimi që ndihmon në vlerësimin e kompetencës digjitale dhe identifikimin e fushave për përmirësim.

- *Hartëzimi i nevojave për trajnime*: identifikimi i mangësive në aftësitë digjitale bazuar në vlerësimin e kompetencave, si dhe mbështetja e mësuesve me programe të përshtatura për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive dhe metodave të mësimdhënies digjitale.

Rezultati i planifikuar:

- Miratimi i një programi trajnimi për aftësitë bazë digjitale për të gjithë mësuesit.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Nivele të unifikuara të aftësive digjitale*: vendosja e një niveli minimal të aftësive bazë të digjitale për të gjithë mësuesit, duke kontribuar në një qasje më të koordinuar dhe të qëndrueshme ndaj arsimit digjital.

- *Adoptimi i përsheptuar i mjeteve digjitale*: rritja e aftësisë së mësuesve për të integruar mjetet dhe burimet digjitale në procesin mësimor, duke sjellë përfitime të drejtpërdrejta për nxënësit;

- *Rrugëtime të trajnimit të personalizuar*: mundësimi i përmirësimit të synuar të aftësive përmes rishikimeve periodike të kompetencave digjitale, duke i udhëzuar mësuesit drejt aktiviteteve të përshtatshme të zhvillimit profesional.

12. Lidhja e programeve të studimit në fushën e mësuesisë me kompetencat digjitale për mësuesit

Ministria e Arsimit është duke punuar vazhdimisht për të adoptuar TIK-un dhe kodimin në kurrikula dhe të ofrojë trajnime të nevojshme për mësuesit. Me rritjen e përdorimit të mjeteve dhe metodave digjitale, mësuesit e rinj pritët të jenë të përditësuar mbi teknologjinë digjitale. Prandaj, ekziston nevoja për të përditësuar programet e edukimit bazë të mësuesve të rinj, me qëllim për t'i përgatitur ata me aftësitë e nevojshme në mbështetje të mësimit digjital.

Kjo masë rekomandon përafrimin e programeve të studimit në fushën e mësuesisë me kompetencat digjitale. Përfshirja e kompetencave digjitale brenda kurrikulave të formimit bazë në arsim, siguron që mësuesit e rinj të jenë të aftë për të integruar në mënyrë efektive teknologjinë në praktikën e tyre të mësimdhënies që nga fillimi i karrierës së tyre.

Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe studimi në fushën e mësuesisë, të cilat mund të përfshijnë:

1. Lëndë të pedagogjisë digjitale: lëndë të detyrueshme ose me zgjedhje që fokusohen në metodat e mësimdhënies digjitale.

2. Orë mësimore: një numër minimal orësh të dedikuara për trajnim në pedagogjinë digjitale, duke siguruar mbulim të plotë të aftësive të nevojshme.

Rezultati i planifikuar

Pajisja me kompetenca digjitale të mësuesve të rinj.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Trajnim digjital i avancuar për mësuesit e rinj*: Siguron që mësuesit e rinj të kenë një nivel bazë të njohurive digjitale, duke u mundësuar atyre të përdorin mjete dhe metoda të mësimdhënies digjitale.

- *Mbështetje nga institucionet e arsimit të lartë*: inkurajon IAL-të që ofrojnë programe në fushën e mësuesisë të ofrojnë mundësi të përshtatshme për të mësuar në mënyrë digjitale për studentët që ndjekin këto programe, duke e përafruar formimin e tyre me nevojat reale të procesit mësimor.

13. Përditësimi i mekanizmit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional online (ZHP) për mësuesit

Ministria e Arsimit është e përkushtuar ndaj zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe përmirësimit të aftësive të mësuesve. Në një botë që po avancohet me ritme të shpejta teknologjike, siç dëshmohet edhe me zhvillimin e Inteligjencës Artificiale, është thelbësore që mësuesit të jenë të përgatitur dhe të trajnuar.

Një mekanizëm i fuqishëm dhe i përditësuar i zhvillimit profesional të vazhdueshëm është çelësi për të siguruar që stafi akademik të zotërojë njohuritë e nevojshme dhe të përdorë teknologjitë më të avancuara në mësimdhënie.

Ministria ofron akses në disa aktivitete të zhvillimit të vazhdueshëm profesional nga një mori ofruesish të akredituar. Këto aktivitete trajnimi janë të aksesueshme nëpërmjet portalit Training4ALL. Gjithashtu, ka iniciativa të tjera që ofrojnë trajnime për mësuesit, si programi CRED4TEACH⁶ i Bashkimit Evropian dhe programet EU4Inclusive për shkollat dhe ESEP/eTwinning. Megjithatë, ekziston nevoja për të centralizuar të gjitha këto burime për t'i ardhur në ndihmë mësuesve që të kenë lehtësisht akses dhe të regjistrojnë pa probleme përparimin e tyre.

Për më tepër, disa aktivitete ofrohen fizikisht ndërsa disa përmes platformave *online*. Pra, mund të jetë sfiduese të mbahet një historik i zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve dhe të ofrohet mbështetje e personalizuar për trajnimin e tyre.

Kjo masë synon të përmirësojë portalet ekzistuese të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve, me qëllim për t'u siguruar mësuesve akses të centralizuar në të gjitha burimet dhe për të mundësuar krijimin e një regjistri digjital të aktiviteteve të tyre në procesin e zhvillimit të vazhdueshëm. Elementet kryesore përfshijnë:

- *Biblioteka e burimeve të hapura arsimore*: një koleksion mjetesh digjitale, video, dhe burime të tjera për të mbështetur mësuesit në mësimin e tyre të vazhdueshëm dhe zhvillimin e aftësive digjitale.

- *Portofola digjitale*: një historik të rrugëtimit të zhvillimit profesional të secilit mësues, duke përdorur IA për të mbështetur përparimin në nivel afatgjatë.

- *Qasja te kurset/aktivitetet online*: Bashkëpunim me ofruesit e trajnimeve, organizatat ndërkombëtare dhe sektorin privat për të ofruar një gamë të gjerë aktiviteteve për rritjen profesionale.

Rezultati i planifikuar:

- Mekanizmi i përmirësuar i zhvillimit të vazhdueshëm profesional me bibliotekë të centralizuar të burimeve të trajnimit, trajnime *online* dhe portofol digjital të mësuesve me linja të personalizuar të të mësuarit.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Qasje më e madhe në aktivitetet e zhvillimit profesional*: U ofron mësuesve një përzgjedhje të larmishme kursesh *online* dhe *offline*, duke mbështetur zhvillimin profesional afatshkurtër dhe afatgjatë.

- *Regjistra të centralizuara të zhvillimit profesional*: Një pikë e vetme aksesit për ndjekjen e aktiviteteve të zhvillimit profesional që mundëson plane mësimore dhe aftësimi të personalizuar.

Kutia 4. Portale për trajnimin e mësuesve⁷

Disa vende të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) kanë zhvilluar portale në internet (*online*) për të mbështetur mësimin e personalizuar për mësuesit, duke ofruar burime të përshtatura për nevojat e arsimit digjital. Për shembull, Réseau CANOPÉ në Francë ofron mjete të tilla, si trajnim në detyrë (*Canotech*), një bankë të praktikave më të mira dhe aktivitete digjitale ndërvepruese, duke i ndihmuar mësuesit të integrojnë teknologjinë në klasat e tyre. DIGISNAP në Belgjikë, i bazuar në mjetin SELFIE për MËSUESIT, u lejon mësuesve të vlerësojnë aftësitë e tyre digjitale dhe të krijojnë plane zhvillimi të personalizuar.

⁶ CRED4TEACH - Shqipëri (n.d.). <https://cred4teach.univlori.edu.al/>

⁷ OECD (2023), *OECD Perspektiva e Arsimit Digjital 2023: Drejt një Ekosistemi Efektiv të Arsimit Digjital*, Botim i OECD-së, Paris, <https://doi.org/10.1787/c74f03de-en>.

14. Vazhdimi i përmirësimit të gjithëpërfshirjes në arsimin digjital

Për fëmijët me aftësi të kufizuara nevojiten strategji të dedikuara për të plotësuar nevojat e tyre të ndryshme të të nxënësve. Qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë disa hapa për të plotësuar mbështetjen dhe integrimin e nxënësve me AK-në në shkollë, duke përfshirë Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara. Ministria e Arsimit po bashkëpunon me partnerë si Fondacioni i Shoqërisë së Hapur të Shqipërisë për të ofruar trajnime të arsimit gjithëpërfshirës për mësuesit dhe për të siguruar gjithëpërfshirjen në kornizën e re të bazuar në kompetenca.

Kjo masë fokusohet në integrimin e teknologjisë mbështetëse, përshtatjen me standardet ndërkombëtare të aksesit në web dhe platforma *online*, si dhe zgjerimin e trajnimeve për mësuesit për të përmirësuar gjithëpërfshirjen në arsim. Veprimet kryesore përfshijnë:

- *Teknologji ndihmëse ose mbështetëse në klasë:* kryerja e vlerësimeve të nevojave për teknologji mbështetëse, duke ndjekur kornizën e UNICEF-it⁸ dhe përshtatja me Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara për të siguruar që teknologjia mbështetëse të përdoret në mënyrë efektive dhe të përshtatshme brenda kuadrit ligjor në fuqi. Në kuadrin e mbështetjes së programit IPA II, jo vetëm janë përmirësuar infrastrukturat fizike të dy qendrave burimore për fëmijët me aftësi ndryshe, që nuk dëgjojnë e nuk shikojnë, por po përgatitet platforma digjitale për nxënësit që nuk shikojnë, që përfaqëson përdorimin konkret të teknologjive ndihmëse për këta nxënës.

- *Akresi në web dhe në platforma mësimore online:* Përshtatja e *platforma mësimore online* me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të aksesueshmërisë, të tilla si udhëzimet e BE-së⁹ për përfshirjen. Gjithashtu, mund të eksplorohet përdorimi i zgjidhjeve të mundësuar përmes IA-së për të përmirësuar aksesin në web. Platforma web e dedikuar zhvillimit profesional të mësuesve është në proces. Kjo platformë do të mundësojë trajnimin dhe vetëtrajnimin *online* të mësuesve, si dhe do të përfshijë në funksionalitetet e veta edhe mjete mësimore TIK të dedikuara për mësuesit drejt përmirësimit të të nxënësve dhe cilësisë së mësimdhënies. Kjo platforme web dhe mobile do të krijohet në kuadrin e implementimit të projektit EU4Teaching, në kuadrin e mbështetjes së programit IPA II.

- *Trajnimi i mësuesve për gjithëpërfshirjen:* zgjerimi i programeve të trajnimit për të mbuluar strategjitë e arsimit gjithëpërfshirës, duke përfshirë opsionet e trajnimeve fizike dhe në internet (*online*). Këto trajnime janë të fokusuara në pedagogjinë gjithëpërfshirëse. Aktualisht janë trajnuar 1830 mësues me fokus gjithëpërfshirjen dhe do të trajnohen gjithsej 15000 mësues të arsimit parauniversitar në kuadrin e mbështetjes së programit IPA II.

Rezultati i planifikuar:

- Një vlerësim i nevojave për teknologjisë mbështetëse (*Assistive Technology*) në shkollë dhe për programe gjithëpërfshirëse të trajnimit të mësuesve.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Zgjerimi i aksesit të nxënësve:* Më shumë nxënës mund të kenë akses në përvojat e të nxënësve digjital, duke e përshtatur këtë të fundit sipas nevojave të tyre.

- *Përputhshmëria me praktikën ndërkombëtare:* Platformat mësimore *online* plotësojnë standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë, duke rritur përafrimin me praktikën globale.

Objektivi 5: Promovimi i kurrikulave digjitale të përditësuara dhe gjithëpërfshirëse

15. Vazhdimi i përditësimit të kurrikulës dhe i kompetencave të TIK-ut për arsimin parauniversitar

Programi i TIK-ut për klasën e parë, të dytë dhe të tretë është hartuar mbi bazën e krijimit të njohurive dhe aftësive digjitale të nxënësve që në moshë të hershme, duke respektuar kuadrin

⁸ Forcimi i ekosistemit kombëtar për ofrimin dhe përdorimin e teknologjisë ndihmëse/komunikim shtesë dhe alternativ për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët me aftësi të kufizuara në Armeni (UNICEF).

⁹ Standardizimi i aksesueshmërisë – Punësimi, Çështjet Sociale dhe Përfshirja – Komisioni Evropian.

moshor dhe nivelin fillestar të njohurive që këta nxënës zotërojnë. Këto programe mësimore janë hartuar në bashkëpunim me specialistë të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), specialistë të Agjencisë Kombëtare të Shqipërisë së Informacionit (AKSHI), përfaqësues të kabinetit të Ministrisë së Shtetit për Fëmijët dhe Rininë, si dhe në bashkëpunim me ekspertin britanik të mundësuar nga AADF-ja.

Kurrikula e re e TIK-ut për klasat I–III prezanton konceptet bazë të TIK-ut duke përfshirë tematika përmbajtjesore, si: bota e kompjuterit, hyrja në multimedia, të menduarit kompjuterik dhe kodimi, si dhe siguria e të punuarit në kompjuter. Platforma “CodeMonkey” është prezantuar, gjithashtu, për të lejuar prezantimin e hershëm me kodimin.

Kjo masë parashikon përditësimin e vazhdueshëm të kurrikulës së TIK-ut dhe kompetencave në arsimin parauniversitar. Me përditësimet tashmë të zbatuara për klasat I deri në III. Kjo kurrikulë do të vazhdojë të zhvillohet dhe të përditësohet në të gjitha klasat e tjera të arsimit parauniversitar, në përputhje me përmbajtjen e kurrikulës së re të hartuar për lëndën e TIK-ut.

Rezultati i planifikuar

- Kurrikula dhe kompetencat e TIK-ut të përditësohen për të gjitha klasat në arsimin parauniversitar.

Rezultatet e tjera të mundshme

- Nxënësit kanë akses në kurrikulën më të fundit të TIK-ut dhe zhvillojnë aftësi të epokës së re.

16. Zhvillimi dhe zbatimi i një programi edukimi për higjienën digjitale

Me rritjen e përdorimit të mjeteve digjitale dhe internetit, nxënësit janë më të ekspozuar ndaj rreziqeve dhe dëmeve digjitale. Ekziston një numër i madh i mashtrimeve dhe i fushatave keqinformuese në internet. Qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë hapa proaktivë për të mbështetur popullatën që të përgatitet më mirë kundër këtyre rreziqeve dhe dëmeve. Këtu përfshihen seminare për sigurinë në internet të drejtuara nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike AKSK në shkollat në Shqipëri me mbështetjen e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. Ministria e Arsimit po bashkëpunon me partnerë, si Këshilli i Evropës për ndërgjegjësimin mbi bullizmin kibernetik, edukimin mediatik, sigurinë në internet si pjesë e¹⁰ projektit “Forcimi i Edukimit për Qytetarinë Demokratike në Shqipëri”.

Përmes këtij dokumenti strategjik, Shqipëria afirmon angazhimin e saj për të ndërtuar **shkolla të sigurta, jo vetëm fizikisht, por edhe në hapësirën digjitale**, në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve.

Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (CRCA) raporton se 60% e fëmijëve përballen me bullizëm kibernetik¹¹, duke nënvizuar nevojën urgjente për marrjen e masave për mbrojtjen e fëmijëve. Kjo masë rekomandon zhvillimin dhe miratimin e një programi gjithëpërfshirës të higjienës digjitale. Kjo përfshin burime në internet dhe trajnime të rregullta për nxënësit, mësuesit dhe prindërit mbi tema si sjellja e sigurt në internet, siguria e të dhënave dhe njohuritë mbi median sociale.

Në dhjetor 2024, Ministria e Arsimit publikoi “Planin kombëtar të veprimit për fuqizimin e mekanizmave të parandalimit të çdo forme dhune e bullizmi, për sigurinë në institucionet arsimore parauniversitare ofron një qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe trajtimin e çdo forme dhune dhe bullizmi në shkolla”. Ky plan synon forcimin e politikave dhe mekanizmave për parandalimin dhe trajtimin e çdo forme dhune dhe bullizmi, përfshirë dhunën fizike, psikologjike dhe bullizmin kibernetik. Një ndër shtyllat kryesore të këtij plani është

¹⁰ Forcimi i Edukimit për Qytetarinë Demokratike në Shqipëri – Arsimi.

¹¹ Crca. (2019, 21 qershor). *60% e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri janë viktimë të bullizmit online*. CRCA. <https://www.crca.al/en/60-femijet-dhe-te-rinjte-ne-Shqipëri-jane-viktima-e-bullying-online/>

siguria në mjediset digjitale, duke adresuar rreziqet në rritje, që lidhen me përdorimin e teknologjisë dhe rrjeteve sociale nga fëmijët dhe të rinjtë.

Në këtë kuadër, plani parashikon masa konkrete për edukimin digjital të nxënësve për sjellje të sigurta *online*, forcimin e kapaciteteve të mësuesve dhe të prindërve për të njohur dhe parandaluar rreziqet kibernetike, ngritjen e strukturave mbështetëse për raportimin dhe ndjekjen e rasteve të bullizmit *online*, përfshirjen e sigurisë kibernetike në programet edukative dhe aktivitetet e shkollave.

Aktivitete të tjera kyçe përfshijnë integrimin e moduleve të higjienës digjitale në kurrikulën kombëtare, zgjerimin e trajnimeve të higjienës digjitale për mësuesit e tjerë jo vetëm të TIK-ut, ofrimin e një kursi të higjienës digjitale për prindërit nëpërmjet SMIP-it dhe kryerjen e fushatave të rregullta ndërgjegjësuere mbi bullizmin kibernetik dhe sigurinë në internet. Tema të rëndësishme mbulojnë ndërgjegjësimin (qytetësaria digjitale, shkrim-leximin mediatik, ngacmimi kibernetik) dhe sigurinë personale (menaxhimi i fjalëkalimeve, praktikë e shfletimit të sigurt, siguria e mediave sociale).

Rezultat i planifikuar:

- Hartimi dhe implementimi në të gjitha shkollat i një programi edukimi mbi higjienën digjitale.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Rritja e ndërgjegjësimin*: nxënësit, mësuesit dhe prindërit do të fitojnë aftësi thelbësore për të lundruar në hapësirat digjitale në mënyrë të sigurt.

- *Reduktimi i ngacmimeve kibernetike dhe mashtrimeve*: edukimi proaktiv mbi kërcënimet digjitale do të reduktojë incidentet e ngacmimeve kibernetike, shkeljet e të dhënave dhe mashtrimet në internet.

- *Forcimi i palëve të interesuara*: mësuesit dhe prindërit do të jenë më të aftë për të mbështetur mirëqenien digjitale të nxënësve.

Kutia 5. Siguria e fëmijëve në internet

Garantimi i sigurisë së fëmijëve në internet kërkon një përpjekje bashkëpunuese në të gjithë komunitetin e shkollës, me vende si Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Gjermania që ndjekin një qasje unike. Në Mbretërinë e Bashkuar, siguria në internet është pjesë e kurrikulës shkollore, me Projektligjin e Sigurisë *Online* 2023¹² që përforcon masat mbrojtëse. Franca integron sigurinë në internet në kurrikulën e saj dhe detyron trajnimin e mësuesve, duke theksuar, gjithashtu, ndërgjegjësimin e prindërve përmes fushatave kombëtare. Qasja e Gjermanisë përfshin një kornizë mbarëkombëtare për edukimin e medias dhe ligje të rrepta për mbrojtjen e të dhënave, duke siguruar që shkollat të jenë në përputhje me standardet e forta të privatësisë. Strategjitë e çdo vendi pasqyrojnë një angazhim për krijimin e mjediseve digjitale më të sigurta për nxënësit.

17. Përdorimi efektiv i Laboratorëve Inteligjentë (*SmartLabs*)

Që nga viti 2022, Ministria e Arsimit dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) në bashkëpunim me partnerë si Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit, Banka Botërore prezantoi Laboratorët Inteligjentë (*SmartLabs*) në Shqipëri. Bëhet fjalë për laboratorë të rinj me internet Wi-Fi me shpejtësi të lartë, laptopë, tabela interaktive, projektorë dhe komplete robotike. Aktualisht, 316 laboratorë janë funksionalë dhe përdoren kryesisht për kurrikulën e re të TIK-ut për klasat e para. Më pas mbi 600 laboratorë të tjerë do të jenë operacional në 2025–2026, me mbështetjen e fondeve të Bashkimit Evropian.

Kjo masë propozon mënyra të reja për të maksimizuar përdorimin e këtyre laboratorëve. Kjo mund të sigurojë që këta laboratorë të mbështesin një gamë më të gjerë përvojash

¹² Akti i Sigurisë në internet 2023 – Ligjet parlamentare – Parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar.

mësimore, duke optimizuar vlerën e tyre dhe duke përmirësuar të mësuarit digjital në shkolla. Këto përfshijnë:

- *Për mësuesit*: Hapja e laboratorëve për mësuesit që dëshirojnë të përfshijnë mjete digjitale në mësimet e tyre, duke i lejuar ata të përdorin këto hapësira si për qëllime mësimore ashtu edhe për detyra administrative, si futja e të dhënave SMIP ose trajnime profesionale.

- *Për nxënësit*: Lejimi i klubeve të nxënësve të cilët kanë akses në laboratorë për aktivitete jashtëshkollore, duke përfshirë projektet dhe eksplorimin e burimeve digjitale.

- *Për programet*: Zgjerimi i programeve ekzistuese digjitale, të tilla si iniciativa Intel IA për të Rinjtë në Laboratorët Inteligjentë (*SmartLabs*) dhe inkurajimi i projekteve pilot që integrojnë iniciativat e TIK-ut dhe të të mësuarit digjital në kurrikulën shkollore.

Rezultati i planifikuar:

- Hartimi dhe miratimi i një plani shfrytëzimi për laboratorët inteligjentë (*SmartLabs*).

Rezultatet e tjera të mundshme:

- Përdorimi i optimizuar i Laboratorëve Inteligjent (*SmartLabs*): Rritja e aksesit në laboratorë si për nxënësit ashtu edhe për mësuesit duke shpënë në përvoja arsimore më dinamike dhe të pasura me teknologji.

- Qasje e përmirësuar në infrastrukturën digjitale: Mësuesit dhe nxënësit përfitojnë nga ekspozimi i vazhdueshëm ndaj mjeteve moderne digjitale, duke nxitur aftësimin dhe kompetencën digjitale.

18. Përditësimi i përmbajtjes digjitale në përputhje me kurrikulën e përditësuar

Ministria e Arsimit, me mbështetjen e UNICEF-it dhe partnerëve të saj, ka zhvilluar video në internet (*online*) për të gjitha lëndët e arsimit parauniversitar. Kjo ishte një përgjigje e menjëhershme ndaj COVID-19. Këto burime u implementuan në kohë dhe ishin të dobishme duke mundësuar vazhdimësinë e të mësuarit gjatë pandemisë COVID-19. Sot, ato janë të aksesueshme nga të gjithë nxënësit në çdo kohë përmes platformës SMIP dhe YouTube.

Kjo masë rekomandon përditësimin e të gjithë përmbajtjes mësimore në internet për t'u lidhur me kurrikulën më të fundit dhe për të siguruar përditësime periodike në mënyrë që materialet të jenë të disponueshme në vazhdimësi. Përditësimet e rregullta do të sigurojnë që nxënësit të kenë akses në informacion të përditësuar dhe me cilësi të lartë që i vjen në ndihmë mësimi të tyre dhe pasqyron kurrikulën më të fundit.

Rezultati i planifikuar:

- Zhvillimi dhe përditësimi i përmbajtjes së mësimi në internet në përputhje me kurrikulën më të fundit dhe krijimi i një mekanizmi institucional për përditësime periodike.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- Akses në përmbajtjen e mësimi në internet duke e mundësuar mësimin në distancë në çdo kohë dhe kudo.

Objektivi 6: Inkurajimi i angazhimit shumëpalësh në edukimin digjital

19. Krijimi i një udhërrëfyese për të rritur vizibilitetin në internet të institucioneve të arsimit të lartë

Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 thekson rëndësinë e rritjes së shikueshmërisë në internet të institucioneve të arsimit të lartë për të siguruar konkurrencën globale, për të përmirësuar aksesin në informacion dhe për të nxitur kompetencën digjitale. Ndërsa Shqipëria përparon drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, është thelbësore që institucionet e saj arsimore të tërheqin studentë, pedagogë dhe bashkëpunime ndërkombëtare. Prezenca e përmirësuar në internet siguron që studentët, prindërit dhe palët e interesuara të kenë lehtësisht akses në informacion, në lidhje me programet arsimore, proceset e pranimi dhe arritjet institucionale, duke nxitur besimin dhe angazhimin në sistemin arsimor.

Ky rekomandim kërkon krijimin e një udhërrëfyese për të rritur shikueshmërinë në internet të institucioneve të arsimit të lartë. Kjo përfshin përbushjen e objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare të Arsimit.

- C4.1.1 që thekson “zhvillimin e rregulloreve për publikimin e të dhënave dhe dokumenteve përkatëse në faqet e internetit të IAL-ve (*Open Data*)”.

Rezultati i planifikuar

- Miratimi dhe zbatimi i një udhërrëfyesi për angazhimin e IAL-ve.

Rezultatet e tjera të mundshme

- Disponim i lehtë i të gjithë informacionit përkatës *online*, në lidhje me Institucionet e Arsimit të Lartë dhe në institucionet e arsimit parauniversitar.

20. Bashkëpunimi me Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës për përdorimin e teknologjisë në arsim

Në nëntor 2023, Qeveria e Shqipërisë themeloi Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës (AIE). Agjencia po mbështet të gjitha ministrinë në zgjidhjen e disa prej sfidave më urgjente në mënyra unike dhe inovative.

Kjo masë rekomandon një bashkëpunim me Agjencinë për të ndihmuar në adresimin e sfidave kryesore dhe eksplorimin e mundësive për integrimin e teknologjisë në arsim. Ky bashkëpunim mund të përfshijë diskutime të përbashkëta të “*brainstorming*” me ministrinë dhe institucionet përkatëse për të priorizuar temat në përputhje me Planin e Veprimit të Agjendës Digjitale për Arsimin dhe analizën e gjendjes aktuale.

Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës mund të mbështesë kërkimin dhe të zhvillojë zgjidhje të mundshme me kontributin e ekspertëve, duke i testuar këto zgjidhje me palët e interesuara nga shkollat dhe IAL. Me mbështetjen politike dhe financiare, zgjidhjet më premtuese mund të zbatohen dhe të përshkallëzohen përmes bashkëpunimit me qeverinë, donatorët dhe sektorin privat.

Krijimi i Agjencisë për Inovacion dhe Ekselencë në Shqipëri krijon një mundësi unike për ministrinë për të bashkëpunuar në fushat më prioritare.

Rezultati i planifikuar:

- Plan i bashkëpunimit strategjik që siguron shpërndarjen në kohë dhe të suksesshme të rezultateve.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Zgjidhje të personalizuar për sfidat lokale:* bashkëpunimi do të lehtësojë zhvillimin e zgjidhjeve inovative që adresojnë sfidat arsimore specifike të Shqipërisë.

- *Akses në praktikat më të mira globale:* puna me Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës mund të hapë dyert për kërkime ndërkombëtare dhe praktika të konfirmuara në teknologjinë arsimore.

- *Ndërthurja me sektorin privat dhe partnerët ndërkombëtarë.* Falë mandatit për bashkëpunime të hapura, mund të mundësojë lidhjen me ekspertizë vendase dhe të huaj.

Kutia 6. Agjencitë e Inovacionit në nivel global¹³

Kili dhe Uruguai kanë krijuar agjenci të specializuara inovacioni që integrojnë teknologjinë në arsim, duke përmirësuar përvojat e të mësuarit digjital. Në Kili, Qendra për Inovacionin brenda Ministrisë së Arsimit drejton iniciativa si Plan i Miljes së Fundit për të përmirësuar lidhjen dhe koordinimin e IT-së, me qëllim për të menaxhuar infrastrukturën digjitale në shkolla. Qendra për Inovacionin Arsimor e Uruguait, përqendrohet në nxitjen e inovacionit përmes mjeteve si ALEKS për mësimin e personalizuar të matematikës dhe ndryshimi i dizajnit, i cili fuqizon nxënësit dhe punonjësit arsimorë të zhvillojnë zgjidhje për sfidat arsimore. Të dyja vendet përdorin këto agjenci për të nxitur transformimin digjital dhe për të mbështetur mësimin e shekullit XXI.

¹³ Claro, M., & Jara, I. (2020). Fundi i Enlaces: 25 vjet të një politike arsimore TIK në Kili. *Rishikimi i Arsimit Digjital*, 37, 96–108. <https://doi.org/10.1344/der.2020.37.96-108>

21. Organizimi i festivalit kombëtar për arsimin digjital

Në Shqipëri, disa aktorë të sektorit privat kanë kontribuar në nismat e aftësimit digjital. Për shembull, projektet e Vodafone Generation Next dhe Skills Upload Junior¹⁴, si dhe ESEP/eTwinning synojnë të rrisin kapacitetet digjitale të fëmijëve të moshës 12–14 vjeç dhe me gjerë. Ata ofruan trajnime për aftësitë digjitale për nxënësit dhe mësuesit në 80 shkolla deri më tani dhe pritet të shtohen më shumë.

Gjatë pandemisë COVID-19, Ministria e Arsimit bashkëpunoi me Akademi.al me mbështetjen e UNICEF-it për të zhvilluar një portal mësimor në internet (*online*) me videoleksione, vlerësime etj. Ata krijuan mbi 2000 video për të gjitha lëndët për grup-moshat 3–18 vjeç dhe ofruan trajnime për 8000 mësues mbi përdorimin e portalit dhe ofrimin e mësimin *online*.

Megjithatë, angazhimi i sektorit privat mund të rritet veçanërisht në fushën eteknologjive arsimore (Edtech) dhe arsimit digjital. Kjo masë rekomandon krijimin e një aktiviteti digjital të të nxënit që mund të shërbejë si një platformë për mësuesit, sipërmarrësit, inovatorët dhe politikëbërësit për të ndarë praktikat më të mira, për të shfaqur risitë teknologjike dhe për të ndërtuar partneritete.

Festivali do të përfshijë aktivitete të tilla, si ekspozita inovative, diskutime në panel, seminare, hakatone dhe mundësi rrjetëzimi profesional. Pjesëmarrësit do të përfshijnë nxënësit, mësues, sipërmarrje të reja në EdTech, investitorë dhe politikëbërës, me partneritete të mundshme nga fondacionet, kompanitë e teknologjisë, telekomunikacioni dhe shkollat e IT-së.

Rezultati i planifikuar:

- Një festival kombëtar i arsimit digjital do të mbahet deri në vitin 2026.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Promovim i inovacionit dhe bashkëpunimit*: aktiviteti do të krijojë mundësi për ndarjen e njohurive, duke frymëzuar pjesëmarrësit që të adoptojnë teknologji dhe metoda të reja mësimore.

- *Tërheqja e investimeve dhe mbështetja e EdTech*: do të rrisë shikueshmërinë për sipërmarrjet e reja të EdTech, duke tërhequr investime dhe duke inkurajuar zhvillimin e zgjidhjeve lokale.

- Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar: ngjarja mund të tërheqë interes ndërkombëtar, duke ndihmuar Shqipërinë të lidhet me liderët globalë të EdTech.

Kutia 7. Festivalet EdTech

Disa vende organizojnë konferenca arsimore digjitale për të nxitur bashkëpunimet midis sektorit publik dhe privat dhe për të tërhequr mbështetje nga donatorë. Për shembull, Konferenca EdTech e Belgjikës 2024 promovon bashkëpunimin në të gjithë sektorët me mbështetjen e BE-së, ndërsa konferenca e Sllovenisë “Fuqia e edukimit digjital”¹⁵, e mbështetur nga donatorë privatë dhe Ministria e Arsimit, fokusohet në forcimin e kompetencave digjitale. Në Kazakistan, EdCrunch¹⁶, financuar nga Ministria e Arsimit dhe donatorë privatë, lidh entitetet qeveritare me industrinë EdTech. Këto aktivitete u mundësojnë vendeve të avancojnë iniciativat e edukimit digjital përmes bashkëpunësorëve strategjikë dhe mundësive të financimit.

¹⁴ Ngarkimi i aftësive Jr | Arsimi dhe teknologjia, katalizatorë për ndryshim. (nd). <https://skillsuploadjr.eu/>

¹⁵ Konferenca IZZI – Fuqia e Edukimit Digjital (nd). <https://konferenca.izzirokus.si/en/home/>

¹⁶ Teknologjitë e reja në arsim. Konferenca ndërkombëtare EdCrunch Reload (nd-b). Rifresko EdCrunch. <https://edcrunch.online/en>

22. Krijimi i mekanizmave për njohjen e krediteve të programeve/kurseve specifike Kurse Masive të Hapura Online (MOOCs) sipas kërkesës së tregut

Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 trajton nevojën për përafrim më të mirë mes arsimit të lartë dhe tregut të punës. Një nga objektivat specifike, objektivi C3, fokusohet në përmirësimin e lidhjes së arsimit të lartë me tregun e punës. Ky objektivi synon të sigurojë që institucionet e arsimit të lartë të ofrojnë programe që janë më të orientuara drejt nevojave të industrisë dhe punës, duke rritur kështu mundësitë për punësim të të diplomuarve.

Kjo masë politike sugjeron përditësimin e akti rregullator për të pranuar kredite nga programe/Kurse Masive të Hapura Online (MOOC) të njohura në fusha me kërkesë të lartë të tregut të punës. Procesi përfshin hartëzimin e nevojave të tregut të punës, duke u konsultuar me institucionet e arsimit të lartë, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim, INSTAT-i etj., për të identifikuar boshllëqet, rishikimin e politikave akademike për të thjeshtuar transferimin dhe vlerësimin e krediteve, si dhe krijimin e bashkëpunimeve me ofrues të mirënjohur të MOOC-ve. Këto bashkëpunime do t'u mundësonin studentëve të fitojnë kredite për përmbushjen e Kurseve Masive të Hapura Online (MOOC) që plotësojnë kriteret e përcaktuara të cilësisë, veçanërisht në fusha të avancuara si siguria kibernetike dhe intelijenca artificiale. Kjo qasje u mundëson studentëve të fitojnë aftësi që mund të rrisin mundësitë e tyre të punësimit.

Rezultati i planifikuar:

- Të përcaktohen qartë modelet, sistemet, institucionet dhe modalitetet për njohjen e krediteve për kurset e përzgjedhura në Kurset Masive të Hapura Online (MOOC).

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Akses i zgjeruar në arsim cilësor*: studentët fitojnë fleksibilitet dhe akses më të madh në një gamë më të gjerë kursesh, duke zgjeruar aftësitë e tyre.

- *Përputhshmëria me nevojat e tregut të punës*: integrimi i Kurseve Masive të Hapura Online në sistemet e krediteve forcon lidhjet ndërmjet programeve arsimore dhe aftësive të kërkuara nga punëdhënësit.

Kutia 8. Kurse online për kredite universitare

Shtete si Franca, Austria dhe Koreja e Jugut kanë zhvilluar portalet kombëtare Kurse Masive të Hapura për të zgjeruar aksesin në kurset e nivelit universitar. FUN-MOOC i Francës ofron mbi 550 kurse nga 140 partnerë, iMooX i Austrisë ofron rreth 200 kurse dhe Kurset Masive të Hapura Online të Koresë së Jugut ofrojnë mbi 500 kurse TIK. Këto platforma, përgjithësisht falas, ndonjëherë përfshijnë mundësi për të fituar kredite, veçanërisht në Austri dhe Korenë e Jugut. Për më tepër, partneritetet publik-privat, të tilla si bashkëpunimi midis Universitetit Mapúa të Filipineve dhe Coursera-s, i lejojnë studentët të fitojnë certifikata të njohura nga tregu i punës në fusha me kërkesa të larta si analiza e të dhënave dhe shërbimet kompjuterike në Cloud, duke rritur aksesin dhe punësimin.

Kapitulli 3: Burimet financiare

Periudha indikative: 2025–2030

Kostoja indikative totale	6 453 400 000 ALL
---------------------------	-------------------

* Të gjitha vlerat janë indikative, të bazuara në kosto mesatare njësi nga iniciativa të ngjashme dhe të dhëna të raportuara më parë nga MA-ja. Shumat përfundimtare mund të përmirësohen gjatë përgatitjes së përlllogaritjeve të detajuara dhe proceseve të prokurimit.

PLANI I ZBATIMIT – VLERËSIMI I KOSTOS/NDIKIMI NË BUXHET

Nr.	Masat	Parametrat e kostove kryesore	Buxheti i parashikuar në LEK	Burimi i financimit të projektuar	Institucioni zbatues
Objektivi 1. Zgjerimi dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore digjitale					

Nr.	Masat	Parametrat e kostove kryesore	Buxheti i parashikuar në LEK	Burimi i financimit të projektuar	Institucioni zbatues
1	Laboratorë <i>Smart</i> (615 shkolla)	654 laboratorë	3,471,500,000	Buxhet i shtetit + CEB +WBIF	AKSHI/MA
2	Blerja e 5,500 laptopëve për mësuesit e gjimnazeve	5500 laptopë	550,000,000	OPI (IPA)	AKSHI/MA
3	Internet me brez të gjerë & Wi-Fi	€4,333 /shkollë	325,000,000	Buxhet i shtetit + donatorë	AKSHI/MA
4	Krijimi i platformës kombëtare qendrore për menaxhimin e të gjithë informacionit kërkimor shkencor në Shqipëri. (ACRIS)	Sistem	200,000,000	Buxhet i shtetit	AKSHI/MA
Objekti 2. Zhvillimi i standardeve të administrimit dhe të monitorimit të arsimit digjital					
5	Mekanizmi i monitorimit të planit të veprimit	Konsulenca	15,000,000	Buxhet i shtetit	MA/AKSHI
6	Standarde të niveleve të ndryshme për institucionet publike të arsimit të lartë (IAL)	Rishikimi i Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë	5,000,000	Buxhet i shtetit	MA/AKSHI
7	Treguesit kombëtarë dhe administrimi i të dhënave	Konsulencë + trajnimi	5,000,000	Buxhet i shtetit	AKKSHI/MA
Objekti 3. Mundësi dhe inkurajimi në implementimin e teknologjive inovative si IA					
8	Udhëzime dhe pilotime për Gjeneratën-AI	Udhëzues + projekte pilot	2,500,000	Buxhet i shtetit	MA/ASCAP
9	Bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e Teknologjisë së Avancuar	Programe/kurse të përbashkëta	20,000,000	Buxhet i shtetit/donatorë	MA/ASCAP
10	Kurrikula për AI & trajnimet e mësuesve	Zhvillim + trajnim (1,000 mësues)	10,000,000	Buxhet i shtetit/donatorë	MA/ASCAP
Objekti 4. Rritja dhe mbështetja e aftësive digjitale të mësuesve					
11	Trajnimi TIK për të gjithë mësuesit	16,000 mësues + 10 module	62,400,000	Buxhet i shtetit + donatorë	MA/ASCAP
12	Përditësimi i programeve të studimit të arsimit të lartë për pajisjen me aftësi digjitale në formimin fillestar të mësuesve	Përditësimi i HEQ + workshop	10,000,000	Buxhet i shtetit	MA/ASCAP
13	Mekanizëm <i>online</i> për zhvillimin profesional të vazhdueshëm (CPD)	Platforma + përmbajtja	70,000,000	Buxhet i shtetit + donatorë	MA/ASCAP
14	Vazhdim i përmirësimit gjithëpërfshirës në arsimin digjital	Vlerësimi i nevojave + trajnimi	45,000,000	Buxhet i shtetit + donatorë	MA/ASCAP
Objekti 5. Promovimi i kurrikulave digjitale të përditësuara dhe gjithëpërfshirëse					
15	Përditësimi të kurrikulës TIK (arsimi parauniversitar K1-12)	Komisioni + pilot	21,000,000	Buxhet i shtetit	MA/ASCAP
16	Edukimi për higjienën digjitale	Design + rollout	1,000,000	Buxhet i shtetit	MA/ASCAP
17	Plani i përdorimit të laboratorëve <i>Smart</i>	Udhëzime + kalendari	1,000,000	Buxhet i shtetit	MA/ASCAP
18	Përmbajtje/Kontenti digjital sipas kurrikulës		10,000,000	Buxhet i shtetit + donatorë	MA/ASCAP
Objekti 6. Inkurajimi i angazhimit shumëpalësh në edukimin digjital					
19	Hartimi i udhërrëfyesit për rritjen e vizibilitetit <i>online</i> të IAL-ve dhe shkollave	Konsulencë	8,000,000	Buxhet i shtetit + donatorë	MA/AKSHI
20	Hartimi i planit të veprimit për bashkëpunim me agjencinë e inovacionit dhe ekselencës	Plani veprimit + planet pilot	7,000,000	Buxhet i shtetit	MA/AKSHI/AIE
21	Festival Kombëtar për Mësimin Digjital	Aktivitet i përvitshëm	5,000,000	Donatorë + Buxhet i shtetit	MA/AKSHI
22	Hartimi i udhërrëfyesit për njohjen e krediteve nga kurset MOOC	Hartimi i udhërrëfyesit	4,000,000	Buxhet i shtetit + donatorë	MA/AKSHI
Totali					

MATRICA E REZULTATEVE

Nr.	Rekomandim	Objektivat (produkti i planifikuar)	Rezultatet e planifikuara	Periudha afat-shkurtër	Periudha afat-mesme	Periudha afatgjatë	Kostoja financiare indikative e parashikuar në ALL	Institucioni përgjegjës
1	Zgjerim i laboratorëve inteligjentë (<i>SmartLabs</i>) në të	Krijimi i laboratorëve inteligjentë (<i>SmartLabs</i>) me	- Raporti i përmirësuar nxënës-për-pajisje - Qasje universale	2026	2027-2028	2029	3,471,500,000	AKSHI/MA

Nr.	Rekomandim	Objektivat (produkti i planifikuar)	Rezultatet e planifikuara	Periudha afat-shkurtër	Periudha afat-mesme	Periudha afatgjatë	Kostoja financiare indikative e parashikuar në ALL	Institucioni përgjegjës
	gjitha shkollat deri në vitin 2027	akses për çdo shkollë	në pajisjet TIK					
2	Blerja e 5,500 laptopëve për mësuesit e gjimnazeve	Blerja, shpërndarja dhe mundësimi i përdorimit të 5500 laptopëve			2027		550,000,000	AKSHI/MA
3	Vazhdimi me zgjerimin e lidhjes së shpejtë me bandë të gjerë dhe Wi-Fi në të gjitha shkollat	Sigurimi i lidhjes me shpejtësi të lartë (të paktën 30MBits) në të gjitha shkollat	- Akses në internet me shpejtësi të lartë për të gjitha institucionet arsimore dhe integrim i pandërprerë i mësimit digjital	2026	2027-2028	2029	325,000,000	AKSHI/MA
4	Krijimi i platformës kombëtare për menaxhimin e informacionit kërkimor shkencor (ACRIS)	Ngritja e një platforme kombëtare të centralizuar për kërkimin shkencor	Realizim sistemi		2027		200,000,000	AKSHI/MA
5	Krijimi i një mekanizmi për monitorimin dhe mbështetjen e planit të veprimit të agjendës digjitale për arsimin	Miratimi i një mekanizmi monitorues që përfshin monitorim dhe raportim periodik të zbatimit të planit të veprimit	Koordinim qendror efikas për zbatimin e strategjisë dhe politikave dhe programeve e politikave përkatëse	2026			15,000,000	MA/AKSHI
6	Vendosja e standardeve të shkallëzuara për pajisjet digjitale dhe ndërlidhjen në institucionet e arsimit të lartë	Kodi i Cilësisë së Arsimit të lartë përditësohet me kërkesat bazë dhe të avancuara përkatëse të ofrimit të infrastrukturës digjitale bazuar në programet e ofruara	Disponueshmëri e unifikuar e infrastrukturës bazë dhe/ose të avancuar digjitale nëpër institucionet e arsimit të lartë		2027		5,000,000	MA/AKKSHI
7	Finalizimi i treguesve kombëtarë të arsimit dhe miratimi i një strukture të fortë të administrimit të të dhënave arsimore	- Miratimi dhe monitorimi i rregullt i treguesve kombëtarë të arsimit digjital - Miratimi i kuadrit të qeverisjes së të dhënave arsimore	- Kuptimi i hershëm dhe më i mirë i tendencave në arsim dhe aftësia për të marrë vendime të bazuara në të dhëna - Përdorimi i sigurt dhe i përgjegjshëm i të dhënave arsimore	2026	2027		5,000,000	AKKSHI/MA
8	Zhvillimi dhe zbatimi i udhëzuesve dhe i rasteve praktike për përdorimin e IA gjeneruese	- Publikimi i udhëzuesve dhe rasteve përkatëse të përdorimit për IA Gjeneruese - Adoptimi i udhëzuesve në të gjitha institucionet arsimore	- Adoptimi i sigurt dhe i përgjegjshëm i IA në fushat përkatëse të ekosistemit arsimor		2027		2,500,000	MA/ASCAP
9	Zhvillimi i një plani për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për kurset e teknologjisë së avancuar në institucionet e arsimit të lartë	- Krijimi i një kuadri bashkëpunimi ndërkombëtar për kurset e teknologjisë së avancuar dhe të jenë funksionale 2-3 kurse të përbashkëta	- Rritja e aksesit në teknologjinë më të fundit të të mësuarit, duke përmirësuar kapacitetin e fuqisë punëtore dhe nxitjen e inovacionit dhe kërkimit	2026			20,000,000	MA/ASCAP
10	Përfshirja e arsimit mbi IA në kurrikulën e TIK-ut	- Edukimi i IA-së është i integruar në kuadrin e kurrikulës për arsimin parauniversitar	- Rritja e njohurive të IA-së te mësuesit dhe nxënësit	2026	2027		10,000,000	MA/ASCAP
11	Zgjerimi i trajnimeve në TIK për të gjithë mësuesit dhe ofrimi i	- Miratimi i një aktiviteti për aftësitë bazë të TIK për të gjithë mësuesit	- Të gjithë mësuesit kanë nivele bazë të aftësive digjitale, duke mundësuar kështu adoptimin e	2026	2027		62,400,000	MA/ASCAP

Nr.	Rekomandim	Objektivat (produkti i planifikuar)	Rezultatet e planifikuara	Periodha afat-shkurtër	Periodha afat-mesme	Periodha afatgjatë	Kostoja financiare indikative e parashikuar në ALL	Institucioni përgjegjës
	mbështetjes për trajnime bazuar në vlerësime periodike		pandërprerë të metodave të pedagogjisë digjitale					
12	Lidhja e programeve të studimit në fushën e mësuesisë me kompetencat digjitale të kërkuara për mësuesit	Kompetencat digjitale të përfshirë në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë për programet e studimit në fushën e mësuesisë	- Mësuesit e rinj kanë një nivel bazë të aftësive digjitale dhe janë më të përgatitur për të adoptuar metoda dhe mjete digjitale të të mësuarit		2027		10,000,000	MA/ASCAP
13	Përditësimi i mekanizmit <i>online</i> të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në për mësuesit	- Mekanizmi i përmirësuar i zhvillimit të vazhduar profesional me bibliotekë të centralizuara të burimeve të trajnimit, trajnime <i>online</i> dhe portofol digjital të mësuesve me rrugë të personalizuar të të mësuarit	- Ofrimi i zhvillimit të vazhduar profesional përmes një pikë aksesit të lehtë dhe programeve të dedikuara		2027-2028		70,000,000	MA/ASCAP
14	Vazhdimi i përmirësimit të gjithëpërfshirjes në arsimin digjital	- Një vlerësim i nevojave të teknologjisë mbështetëse në shkolla dhe programe gjithëpërfshirëse të trajnimit të mësuesve	- Përvoja e përmirësuar e të mësuarit për fëmijët nga grupe vulnerabël të popullatës		2027-2028	2029	45,000,000	MA/ASCAP
15	Vazhdimi i përditësimit të kurrikulës dhe kompetencave të TIK-ut për arsimin parauniversitar	- Kurrikula dhe kompetencat e TIK janë përditësuar për të gjitha klasat në nivelin parauniversitar	- Studentët kanë akses në kurrikulën më të fundit të TIK-ut dhe zhvillojnë aftësi të epokës së re	2026			21,000,000	MA/ASCAP
16	Zhvillimi dhe zbatimi i një programi edukimi mbi higjienën digjitale	- Një program edukimi për higjienën digjitale është zhvilluar dhe zbatuar në të gjitha shkollat	- Angazhim i sigurt dhe i përgjegjshëm me mjetet e edukimit digjital	2026	2027		1,000,000	MA/ASCAP
17	Bërja e mundur e përdorimit efektiv të laboratorëve inteligjent (<i>SmartLabs</i>)	- Hartimi dhe miratimi i një plani shfrytëzimi për laboratorët inteligjent (<i>SmartLabs</i>)	- Shfrytëzimi efektiv i infrastrukturës së re digjitale të laboratorëve inteligjentë	2026	2027		1,000,000	MA/ASCAP
18	Përditësimi i përmbajtjes digjitale sipas kurrikulës së përditësuar	- Zhvillimi digjital i përmbajtjes së mësimit në internet në përputhje me kurrikulën më të fundit dhe krijimi i një mekanizmi institucional për përditësime periodike	- Akses digjital në përmbajtjen e mësimit në internet duke e mundur mësimin në distancë në çdo kohë dhe kudo	2027			10,000,000	MA/ASCAP
19	Krijimi i një udhërrëfyese për të rritur shikueshmërinë në internet të institucioneve dhe shkollave të arsimit të lartë	- Miratimi dhe zbatimi i udhërrëfyesis	- Disponueshmëri e lehtë e të gjithë informacionit përkatës <i>online</i> në lidhje me IAL-të dhe shkollat	2026	2027		8,000,000	MA/AKKSHI
20	Bashkëpunimi me Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës për përdorimin e teknologjisë në arsim	Plani strategjik i bashkëpunimit që siguron rezultate në kohë dhe të suksesshme	- Zgjidhje inovative për përdorimin e teknologjisë në arsim	2026	2027		7,000,000	MA/AKKSHI
21	Organizimi i festivalit të mësimit digjital në	- Mbajtja një festivali vjetor mbi mësimin digjital	- Përmirësimi i angazhimit midis grupeve të interesit		2027		5,000,000	MA/AKKSHI

Nr.	Rekomandim	Objektivat (produkti i planifikuar)	Rezultatet e planifikuara	Periudha afat-shkurtër	Periudha afat-mesme	Periudha afatgjatë	Kostoja financiare indikative e parashikuar në ALL	Institucioni përgjegjës
	Shqipëri		të arsimit digjital dhe EdTech, duke mundësuar inovacion, bashkëpunim dhe investime					
22	Njohja e krediteve për disa Kurse Masive të Hapura Online (MOOCs), sipas kërkesës së tregut	- Kurset Masive të Hapura Online (MOOCs) njihen zyrtarisht me kredite për disa kurse të përzgjedhura	- Akses në kurset me kërkesë të lartë në tregun e punës		2028–2029		4,000,000	MA/AKKSHI

SHKURTESA

Shkurtesa	Formulimi i plotë
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
AADF	Fondi Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit
OSFA	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
KE	Këshilli i Evropës
MA	Ministria e Arsimit
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
RASH	Qendra e Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar
SMIP	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar
SMIAL	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Institucionet e Arsimit të Lartë
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar
AKAP	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar
ASCAL	Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
ZVAP	Zyrat Vendore Arsimore Parauniversitare
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve
IAL	Institucionet e arsimit të lartë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale